LIGJ
Nr. 58/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE PËR GRANTIN E ASISTENCËS FINANCIARE PËR PROJEKTIN "NGRITJA E KAPACITETEVE PËR ZHVILLIMET NË PËRMASA TË MËDHA TË INFRASTRUKTURËS SË GAZIT NË SHQIPËRI, II"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për grantin e asistencës financiare për projektin "Ngritja e kapaciteteve për zhvillimet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit në Shqipëri, II", në shumën prej 6 600 000 (gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) eurosh, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.5.2015

Shpallur me dekretin nr. 9139, datë 16.6.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE PROJEKTI

NDËRMJET QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI GRANTIN E ASISTENCËS FINANCIARE PËR PROJEKTIN E NGRITJES SË KAPACITETEVE PËR ZHVILLIMET NË PËRMASA TË MËDHA TË INFRASTRUKTURËS SË GAZIT NË SHQIPËRI, II

Qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë dhe Ministria e Financave,

duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe të nënshkruar në Tiranë, më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9801, të datës 13 shtator 2007;

me dëshirën për të forcuar këto marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunimin e frytshëm midis dy vendeve;

me synim nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë;

duke njohur zotimin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të vazhduar reformat në mënyrë që të krijojë një ekonomi tregu sipas kushteve demokratike, dhe për të ofruar një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm nga pikëpamja ekologjike për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm;

duke pranuar se projekti bazohet në objektivat e diversifikimit të energjisë të shprehur në Draftstrategjinë

Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 - 2020;

duke pasur në konsideratë grantin e asistencës financiare zvicerane për projektin e ngritjes së kapaciteteve për zhvillimet në Përmasa të Mëdha të Infrastrukturës së Gazit në Shqipëri II për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave të Shqipërisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Në këtë marrëveshje projekti, përveç kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimin si më poshtë:

a) "Qeveria e Shqipërisë" nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë dhe Ministria e Financave;

b) "Qeveria Zvicerane" nënkupton Qeverinë e Konfederatës Zvicerane (Këshillin Federal Zviceran) të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike;

c) "MEI" nënkupton Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë;

d) "MF" nënkupton Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë;

e) "ERE" nënkupton Entin Rregullator të Energjisë të Republikës së Shqipërisë;

f) "Albpetrol" sh.a. nënkupton kompaninë shtetërore shqiptare të naftës bruto dhe të nxjerrjes së gazit;

g) "SECO" nënkupton Sekretariatin e Shtetit për Çështjet Ekonomike të Konfederatës Zvicerane;

h) "Palët Kontraktuese" nënkupton Qeverinë e Shqipërisë dhe Qeverinë Zvicerane;

i) "Marrëveshja Kuadër" nënkupton Marrëveshjen ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar të lidhur dhe të nënshkruar, më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9801, të datës 13 shtator 2007;

j) "Projekti" nënkupton Projektin për Ngritjen e Kapaciteteve për Zhvillimet në Përmasa të Mëdha të Infrastrukturës së Gazit në Shqipëri II;

k) "Marrëveshja e Projektit" nënkupton këtë Marrëveshje, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese në lidhje me Projektin, në vijim re referuar gjithashtu si MP;

l) "Kontributi" nënkupton kontributin financiar të parimbursueshëm të dhënë nga SECO-ja sipas MP-së;

m) "NJKP" nënkupton Njësinë për Koordinimin e Projektit që ka për detyrë koordinimin dhe menaxhimin e Projektit, e ngritur në Drejtorinë e Integrimit dhe Projekteve në MEI;

n) "TAP" nënkupton Gazsjellësin Trans Adriatik;

o) "MQVP" nënkupton Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës duke përfshirë "Marrëveshjen Referuese", të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe konsorciumit të TAP-it dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 116/2013, të datës 15 prill 2013;

p) "MNQ" nënkupton Marrëveshjen Ndërqeveritare të nënshkruar ndërmjet qeverive të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 104/2013, të datës 25 mars 2013;

q) "Task Forca" nënkupton strukturën qeveritare e cila ka përgjegjësinë e përgjithshme për të mbështetur zbatimin e TAP-it dhe për zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri, e cila përbëhet nga përfaqësuesit e ministrive shqiptare, të përfshira dhe nga institucione të tjera që kanë lidhje me Projektin;

r) "Komisioni Ndërinstitucional" nënkupton nivelin politik të Task Forcës, përgjegjës për vendimmarrjen dhe bashkërendimin e politikave në lidhje me zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri dhe zbatimin e TAP-it. Krijimi dhe funksionimi i Komisionit Ndërinstitucional përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nr. 1081, të datës 18 dhjetor 2013;

s) "GTE" nënkupton Grupin Teknik të Ekspertëve, nivelin teknik të Task Forcës, përgjegjës për detyrat operative në lidhje me zbatimin e TAP-it dhe zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri. Krijimi dhe funksionimi i GTE-së përcaktohet në urdhrin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, nr. 158, të datës 3 prill 2014;

t) "Komiteti Drejtues" nënkupton komitetin drejtues të ngritur për Projektin;

u) "Konsulent" nënkupton ekspertët që ofrojnë shërbime në lidhje me konsulencën dhe ngritjen e kapaciteteve për Projektin;

v) "Mbështetësi" nënkupton konsulentët ndërkombëtarë të cilët mbështesin SECO-n dhe MEI-n gjatë proceseve të tenderimit, monitorimit dhe raportimit të Projektit;

w) "Udhëzimet e Prokurimit të SECO-s" nënkupton tërësinë e rregullave dhe të kushteve në dokumentin "Udhëzime për dhënien e kontratave në kuadër të financimit të infrastrukturës nga SECO-ja në vendet në tranzicion dhe në zhvillim";

x) "Politikat e Auditimit Financiar të SECO-s" nënkupton udhëzimet për auditime në lidhje me projektet e financuara nga SECO-ja; dhe

z. "TVSH" nënkupton Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Neni 2

Objektivi dhe qëllimi i Kontributit

2.1 Objektivi i përgjithshëm i Kontributit është që të ngrejë kapacitetet e nevojshme brenda institucioneve publike dhe autoriteteve qeveritare përkatëse shqiptare, si dhe të rrisë dhe të përditësojë kuadrin ligjor, teknik dhe institucional për të zhvilluar tregun e gazit në Shqipëri, për të zbatuar TAP-in dhe për të menaxhuar projektet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit.

Shërbimet e konsulencës dhe ato për ngritjen e kapaciteteve për Projektin do të mbështesin Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, në:

i) shfrytëzimin e mundësive potenciale për të rritur sigurimin e energjisë, duke diversifikuar kombinimin e energjisë dhe burimet e energjisë;

ii) mbështetjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet një kornize investimesh më të qëndrueshme nga këndvështrimi i zhvillimit të një tregu të brendshëm gazi;

iii) zhvillimin e strategjive sektoriale, politikave dhe organizimin e analizave ekonomike të tregjeve energjetike; menaxhimin e rregullave, lejeve dhe proceset e zhvillimit të projektit; ngritjen dhe forcimin e institucioneve specifike të sektorit;

iv) rritjen e aftësisë për të zbatuar dhe për të vendosur masa mbrojtëse mjedisore, sociale dhe të sigurisë gjatë ndërtimit të objekteve në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit brenda territorit të saj;

v) sigurimin e një kuadri rregullator të favorshëm që të përdorë në mënyrën më optimale burimet publike shtesë të krijuara prej projekteve me përmasa të mëdha të infrastrukturave të gazit;

vi) uljen e çlirimit të gazrave serë përmes uljes së energjisë të importuar të bazuar në fosile;

vii) rritjen e aftësive menaxheriale për zbatimin e projektit dhe forcimin e aftësive të tij komunikuese për sektorët e gazit dhe të energjisë.

Ju lutem, referojuni aneksit 1 për përshkrimin e detajuar të projektit.

2.2 Rezultatet e pritshme përfshijnë: 1) hartimin e strategjive dhe dokumenteve të politikave në sektorin energjetik (Strategjinë e sektorit shqiptar energjetik, studimin për zhvillimin e tregut të gazit, masterplanin e infrastrukturës së gazit) dhe paraqitjen e një analize mbi mundësitë e lehtësimit të ndryshimit klimatik për infrastrukturën e pjesës së poshtme të rrjedhjes, bazuar në tregun e ardhshëm të gazit në Shqipëri; 2) hartimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor, teknik dhe institucional në sektorin e gazit natyror, në përputhje me direktivat e BE-së, kryesisht në fushat e mëposhtme kyçe: a) marrëveshjet me TAP-in (Marrëveshja me qeverinë e vendit pritës, marrëveshja referuese, marrëveshja mbi përfitimet për vendin, marrëveshja për zhvillimin e tregut të gazit; b) procedurat për lejet dhe licencimin; c) rregulloret e vendit për gazin; d) rregullat dhe proceset për blerjen dhe servitutin e tokës; e) rregullore për çështjet shëndetësore, të sigurisë dhe mjedisore, si dhe për standardet sociale; 3) qeverisjen e përmirësuar të autoriteteve shqiptare, duke përfshirë ERE-n për projektet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit; 4) krijimin dhe ngritjen e institucioneve kompetente shqiptare, duke përfshirë mbështetjen e institutit të naftës dhe të gazit, agjencive dhe operatorëve aktivë për sektorin e ardhshëm të gazit; 5) forcimin e kompetencave përkatëse të qeverisë shqiptare për koordinimin, zbatimin ndërministror të projektit; si dhe 6) komunikimin efikas dhe përfaqësimin e Qeverisë Shqiptare në kuadrin e TAP-it dhe gazifikimit të vendit.

Objektivat dhe rezultatet e detajuara që duhet të arrihen janë përcaktuar në kuadrin logjik në aneksin 2.

Neni 3

Shuma dhe përdorimi i Kontributit

3.1 SECO-ja bie dakord t'i japë një Kontribut të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej 6,600,000 eurosh (gjashtë milionë e gjashtëqind mijë euro) Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Projektit, siç përshkruhet në Konceptin e Projektit të bashkëlidhur (aneksi 1). Kjo shumë përfshin fillimisht 6,000,000 euro (gjashtë milionë euro) për shërbimet e këshillimit dhe të ngritjes së kapaciteteve, 600,000

euro (gjashtëqind mijë euro) për financimin e Mbështetësit, auditimet financiare dhe studimin opsional të Projektit për mbylljen graduale dhe studimet e vlerësimit pas përfundimit.

3.2 Pagesat nga Kontributi do të jenë në varësi të kredive vjetore të paguara kundrejt SECO-s nga Parlamenti Federal i Zvicrës. Kushtëzimi i këtyre pagesave nuk duhet të ndikojë në zotimin e plotë të SECO-s sipas MP-së në përputhje me nenin 3.1 të MP-së.

3.3 Pas përfundimit të Projektit çdo pajisje e blerë për këtë projekt do të bëhet pronë e MEI-t ose e ndonjë autoriteti/autoriteteve të tjera që është përgjegjës për sektorin e çështjeve energjetike.

3.4 Asnjë nga të ardhurat e Kontributit nuk do të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç veprimtarive të planifikuara në Projekt.

3.5 Asnjë nga të ardhurat e Kontributit nuk do të përdoren për të paguar ndonjë detyrim apo taksa, si për shembull TVSH-në, detyrimin doganor, detyrimin e importit, taksa, çfarëdo tarife apo ndonjë të tillë e detyruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë apo ndonjë subjekti të varur shtetëror.

3.6 Çdo pjesë e papërdorur e Kontributit që mbetet pasi të jenë përmbushur të gjitha detyrimet, përkatësisht pas përfundimit të MP-së, sipas nenit 12, paragrafi 2, do të anulohet, me përjashtim të rastit kur Palët Kontraktuese bien dakord reciprokisht ndryshe.

Neni 4

Kushtet e kontributit

4.1 Detyrat paraprake të mëposhtme janë kushtëzuese për fillimin e Projektit dhe duhet të përmbushen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë:

- Task Forca duhet të ngrihet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë: Kjo përfshin emërimin e Anëtarëve të Komisionit Ndërinstitucional, si dhe anëtarët e GTE-së.

- Anëtarët e GTE-së janë caktuar që të punojnë brenda hapësirave të zyrave të MEI-t deri në 3 ditë në javë me kohë të plotë, sipas planit vjetor të punës të miratuar nga komiteti drejtues. Është krijuar mjedisi i përshtatshëm i punës për GTE-në, ku përfshihet telefoni dhe lidhja e internetit.

- NJK-ja duhet të krijohet te MEI.

4.2 Përkushtimi i Qeverisë së Shqipërisë është faktor kyç suksesi për Projektin. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të ofrojë mbështetje të fuqishme të vazhdueshme për Projektin. Si rrjedhojë, Kontributi varet nga arritja nga Qeveria Shqiptare e synimeve të përcaktuara në aneksin 4.

4.3 Me përjashtim të rastit kur MP-ja ka dispozita të veçanta, të cilat nuk janë trajtuar nga termat e Marrëveshjes Kuadër, dispozitat e Marrëveshjes Kuadër do të zbatohen plotësisht. Në veçanti, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të sigurojë kushtet për zbatimin e Projektit, sipas nenit 4 të Marrëveshjes Kuadër.

4.4 Qeveria e Shqipërisë do t'u japë menjëherë dhe pa ndonjë pengesë administrative, vizat e nevojshme hyrëse falas Konsulentit, Mbështetësve, si dhe cilitdo kontraktuesi tjetër të huaj të përfshirë në Projekt, si dhe do të mundësojë përjashtimin nga ndonjë detyrim doganor, taksa dhe detyrime të tjera të vendosura nga ligjet e Republikës së Shqipërisë apo të ndonjë subjekti të varur shtetëror, të zbatueshme për të gjitha pagat, sendet personale dhe pajisjet e nevojshme për detyrat e tyre në këtë Projekt.

4.5 MEI do të lehtësojë importimin e përkohshëm dhe më pas rieksportimin nga Shqipëria të të gjitha pajisjeve në pronësinë e Konsulentit, të Mbështetësit dhe cilitdo kontraktuesi të huaj në lidhje me ofrimin e shërbimeve të tyre.

4.6 MEI vë në dispozicion buxhet të nevojshëm për të garantuar rimbursimin e TVSH-së, në lidhje me shpenzimet e Projektit, për një shumë vjetore të llogaritur prej 260,000 eurosh (dyqind e gjashtëdhjetë mijë euro).

4.7 Qeveria e Shqipërisë duhet të garantojë zbatimin dhe vendosjen e masave mbrojtëse mjedisore sociale gjatë ndërtimit të zhvillimeve me përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit brenda territorit të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet e politikave sociale dhe mjedisore të BERZH-it (2008), kryesisht kërkesat e performancës 1, 3, 4, 5 dhe 10, të cilat përqendrohen përkatësisht në vlerësimin social dhe menaxhimin; parandalimin dhe uljen e nivelit të ndotjes; sigurimin dhe sigurinë e shëndetit të komunitetit; blerjen e tokës, zhvendosjen jovullnetare/të detyruar dhe zëvendësimin ekonomik, si edhe projektpolitikat sociale dhe mjedisore të BERZH-it (2014).

4.8 Qeveria e Shqipërisë duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar akses të plotë dhe të shpejtë për personat e përfshirë në këtë Projekt në lidhje me informacionin e kërkuar teknik dhe institucional.

4.9 Në mënyrë që të sigurohet vizibiliteti i Kontributit, të gjitha materialet e marrëdhënieve me publikun

dhe të gjitha dokumentet e përgatitura sipas Projektit, duhet t'i referohen faktit se Projekti është financuar nga Qeveria Zvicerane dhe të shfaqin logon e Qeverisë Zvicerane.

Neni 5

Organizimi i Projektit dhe përgjegjësia

Task Forca

5.1 Task Forcës, NJKP-ja dhe punonjësve kyçë në ministritë dhe në institucionet e përfshira shqiptare do t'u ofrohen shërbime në fushën e konsulencës dhe ngritjen e kapaciteteve. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të emërojë Task Forcën dhe NJKP-në përpara fillimit të Projektit. Task Forca përbëhet nga dy nivele, një nivel politik për vendimmarrjen dhe bashkërendimin e politikave (Komisioni Ndërinstitucional), si edhe një nivel teknik përgjegjës për detyrat operative në lidhje me zbatimin e TAP-it dhe zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri (GTE). Komisioni Ndërinstitucional dhe GTE-ja do të drejtohen nga përfaqësuesit e MEI-t.

Komisioni Ndërinstitucional

5.1.1Komisioni Ndërinstitucional është një strukturë politike që merr vendime strategjike dhe mbështet institucionet apo struktura të tjera qeveritare për zbatimin e hapave të nevojshëm në drejtim të realizimit të TAP-it dhe të zhvillimit të tregut të gazit në Shqipëri. Komisioni Ndërinstitucional, i drejtuar nga ministri i MEI-t, përbëhet nga përfaqësuesit e përmendur më poshtë:

Zëvendësministrat e ministrive të mëposhtme:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë; e Punëve të Brendshme; e Financave; e Drejtësisë; e Mjedisit; e Zhvillimit Urban dhe Turizmit; e Transportit dhe Infrastrukturës; e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

Zëvendësdrejtorët nga:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Drejtoria e Përgjithshme e Taksave; Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

Drejtori i Politikave të Karburanteve dhe Zhvillimit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

Grupi Teknik i Ekspertëve (GTE)

5.1.2 GTE-ja është strukturë funksionale dhe koordinimi që orienton në emër të MEI, mbështetjen e zbatimit të projektit të TAP-it dhe aktivitetet e ndërmarra për zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri. GTE-ja e drejtuar nga ministri i Energjisë dhe Industrisë përbëhet nga nëpunës civilë të deleguar nga secili prej institucioneve të përmendura më poshtë:

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë; e Punëve të Brendshme; e Financave; e Drejtësisë; e Mjedisit; e Zhvillimit Urban dhe Turizmit; e Transportit dhe Infrastrukturës; e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA); Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT).

5.1.3 Anëtarët e GTE-së janë nëpunës civilë me lidhje të qarta sipas disiplinave përkatëse me ministritë/agjencitë të përfaqësuar në Komisionin Ndërinstitucional. Ata duhet të jenë drejtorë të sektorëve ose anëtarë të ekipeve, me përgjegjësi operacionale në institucionet e tyre. Ata janë caktuar zyrtarisht në GTE nëpërmjet një udhëzimi detyrues të nxjerrë nga secili ministër, ose nga drejtori i agjencisë përkatëse, në mënyrë që këta nëpunës civilë të urdhërohen zyrtarisht për t'u bërë anëtarë të GTE-së. Për emërimet e reja të anëtarëve të GTE-së duhet të merret në konsideratë mendimi i SECO-s.

5.1.4 Siç përcaktohet në versionin e ndryshuar të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1081, datë 18.12.2013, si edhe në urdhrin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 158, datë 3.4.2014 (aneksi 5), për përcaktimin e nëpunësve të mjaftueshëm civilë dhe ditëve të tyre të punës të nevojshme në GTE, ministrat ose drejtorët e agjencive që dërgojnë anëtarë në GTE do të ofrojnë të gjithë mbështetjen e nevojshme që do të duhet për zbatimin e Projektit, dhe do të alokojnë burimet e duhura për nëpunësit e tyre civilë për të ndërvepruar me Konsulentin, kontraktuesit e tjerë dhe çdo palë tjetër interesi e Projektit. Ditët e punës në GTE llogariten deri në 3 ditë të plota pune në javë dhe mund të ndryshojnë në varësi të detyrave operacionale që duhet të realizohen nga Projekti, sipas planeve vjetore të punës të miratuara nga komiteti drejtues.

5.1.5 Ministrat ose drejtorët e agjencive që dërgojnë anëtarë në GTE do të informojnë personelin kyç në ministritë/agjencitë e tyre për rolin e anëtarëve të GTE-së në lidhje me Projektin.

5.1.6 Anëtarët e GTE-së do të emërohen duke pasur parasysh detyrat specifike për transferimin e njohurive midis GTE-së dhe ministrive/agjencive të tyre.

5.1.7Anëtarët e GTE-së do të ndajnë zyrat e përbashkëta të vëna në dispozicion nga MEI gjatë kohës që do të punojnë për Projektin.

Më shumë të dhëna në lidhje me organizimin dhe përgjegjësitë e Projektit jepen në Konceptin e Projektit në aneksin 1.

Roli i MEI-t

5.2 MEI ka përgjegjësinë e përgjithshme për realizimin e Projektit dhe duhet të ndërmarrë ose të marrë masa që të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme ose të përshtatshme për kryerjen e Projektit në kohën e duhur. Në këtë aspekt, ajo do të drejtojë Komisionin Ndërinstitucional dhe GTE-në, do të delegojë një përfaqësues në Komitetin Drejtues (referojuni nenit 5.7), si dhe do të koordinojë Konsulentin dhe kontraktuesit e tjerë me autoritetet qeveritare të përfshira në aktivitetet e Projektit.

Roli i NJKP-së

5.3 MEI do të emërojë një NJKP me kualifikimet e nevojshme teknike dhe kompetencat administrative që të jetë përgjegjëse për prokurimet dhe zbatimet operative të projektit (tenderët, monitorimin, raportimin, proceset administrative, menaxhimin e kontratës). NJKP-ja do të hartojë progresraporte të Projektit dy herë në vit, do të hartojë dhe do të monitorojë planet vjetore të punës për GTE-në dhe të punonjësve kyçë në ministritë përkatëse. Për emërimin e anëtarëve të NJKP-së duhet të merret në konsideratë mendimi i SECO-s.

5.4 Kostot e lidhura me Task Forcën dhe NJKP-në mbulohen nga Qeveria e Shqipërisë.

Roli i SECO-s

5.5 SECO-ja është autoriteti përgjegjës për palën zvicerane dhe:

- do të japë një Kontribut të parimbursueshëm siç është e përcaktuar në nenin 3 të MP-së;
- do të ushtrojë të drejtat e saj jokundërshtuese në lidhje me dokumentet e tenderit, raportet e vlerësimit të tenderit, dhënies së kontratës, kontratat e negocimit, kontratat e nënshkruara dhe ndryshimet e kontratave;
- do të konsultohet për emërimin e anëtarëve të GTE-së dhe NJKP-së dhe do të bëjë rekomandime nëse është e nevojshme;
- do të monitorojë arritjet e fazave të Projektit;

- do të paguajë në kohë Konsulentin dhe kontraktuesit e tjerë sipas këtij Projekti pas miratimit me shkrim të palëve përgjegjëse.

Roli i Ambasadës Zvicerane

5.6 Ambasada Zvicerane do të përfaqësojë SECO-n në Projekt dhe:

- do të mbikëqyrë Projektin në lidhje me Bashkëpunimin Zviceran dhe do të ndjekë nga afër zhvillimet në sektorin energjetik;
- do të delegojë një përfaqësues në Komitetin Drejtues.

Komiteti Drejtues

5.7 Një Komitet Drejtues do të monitorojë Projektin nga pikëpamja strategjike. Komiteti Drejtues do të përbëhet nga përfaqësues të SECO-s ose të Ambasadës Zvicerane, MEI dhe MF-ja dhe do të drejtohet nga MEI. Vendimet merren në mënyrë unanime nga Komiteti Drejtues. Ai mund të ftojë palë të tjera të interesuara në takimet e tij, pa të drejtë vote, atëherë kur e çmon të arsyeshme dhe pasi është rënë dakord ndërmjet anëtarëve të Komitetit Drejtues. Për qëllime monitorimi, Komiteti Drejtues duhet të bjerë dakord për një sistem monitorimi, dhe të funksionojë në bazë të atij sistemi. Komiteti Drejtues miraton planin vjetor të punës së GTE-së (shihni nenin 5.2).

Neni 6

Prokurimi, kontratat dhe procedurat e pagimit

6.1 Procedurat e tenderimit për Konsulentin dhe kontraktuesit e tjerë, me përjashtim të dispozitave të shprehura në paragrafët 6.2, 6.3, 6.4 dhe 6.5 do të prokurohen nga MEI sipas Udhëzimeve të Prokurimit të SECO-s. SECO-ja do të përdorë të drejtat e saj jokundërshtuese në lidhje me dokumentet e tenderit, raportet e vlerësimit të tenderit, dhënies së kontratës, kontratat e negociuara, kontratat e nënshkruara dhe ndryshimet e kontratave. Kontrata do të nënshkruhet përkatësisht ndërmjet Konsulentit dhe MEI-t dhe të kontraktuesve të tjerë të mundshëm dhe MEI-t. Pagesat e Konsulentit dhe të kontraktuesve të tjerë do të kryhen drejtpërdrejt nga SECO-ja mbi bazën e dy faturave origjinale, njëra nga të cilat i dërgohet MEI-t dhe e dyta i dërgohet paralelisht SECO-s. Pagesat do të kryhen nga SECO-ja pas marrjes së miratimit me shkrim të një kopjeje të faturave nga NJKP-ja. SECO-ja rezervon të drejtën për të vazhduar me pagesat nëse nuk ka

asnjë koment me shkrim në fatura brenda 45 ditëve nga data e marrjes së faturave nga NJKP-ja.

6.2 SECO-ja dhe MEI do të mbështeten nga Mbështetësit në fushat e mëposhtme: i) përgatitjen e termave të referencës së tenderëve dhe për vlerësimin e tenderëve të Konsulentit; dhe ii) me vlerësimin e raportit fillestar dhe të raporteve nga NJKP-ja dhe Konsulenti. Kontratat e Mbështetësve do të prokurohen nga SECO-ja sipas Udhëzimeve të Prokurimeve të SECO-s. Kontratat do të nënshkruhen ndërmjet SECO-s dhe Mbështetësve. SECO-ja do të miratojë drejtpërdrejt faturat dhe do të kryejë pagesat.

6.3 Nëse çmohet e nevojshme, SECO-ja do të emërojë ekspertë për të ndërmarrë një studim për mbylljen graduale të projektit në fund të Projektit për të siguruar një mbyllje të qetë dhe të qëndrueshme të Projektit. Kontrata për studimin opsional për fazën mbyllëse të Projektit do të prokurohet nga SECO në bazë të Udhëzimeve të Prokurimeve të SECO-s. Kontrata do të nënshkruhet ndërmjet SECO-s dhe ekspertëve të përzgjedhur. SECO-ja do të miratojë drejtpërdrejt faturat dhe do të kryejë pagesat.

6.4 Nëse çmohet e nevojshme SECO-ja do të emërojë ekspertë për të ndërmarrë një vlerësim pas përfundimit të projektit. Kontrata për studimin opsional për vlerësimin pas përfundimit do të prokurohet nga SECO-ja në bazë të Udhëzimeve të Prokurimeve të SECO-s. Kontrata do të nënshkruhet ndërmjet SECO-s dhe ekspertëve të përzgjedhur. SECO-ja do të miratojë drejtpërdrejt faturat dhe do të kryejë pagesat.

6.5 Audituesit për auditimet financiare kontraktohen ose nga SECO-ja, ose nga Konsulenti. Audituesit duhet të jenë të kualifikuar dhe të pavarur, në mënyrë që të kryejnë auditime sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit (ISA), si edhe sipas standardeve të aplikueshme në shtetin ku po zbatohet ky mandat.

Neni 7
Zbatimi i Projektit

7.1 Si një parim që udhëheq zbatimin e Projektit, anëtarët e të gjitha strukturave të përfshira do të përpiqen gjithmonë të veprojnë në një frymë bashkëpunimi dhe të marrin vendime me konsensus. Nëse dhe kurdo që të jetë e nevojshme, Palët Kontraktuese duhet, me kërkesën e secilës Palë:

a) të shkëmbejnë mendime në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse sipas MP-së, administrimin e Kontributit dhe veprimet e financuara nga Kontributi;

b) t'i ofrojë Palës tjetër Kontraktuese të gjithë informacionin që do të kërkohet në mënyrë të arsyeshme në lidhje me ekzekutimin e Kontributit dhe veprimet e financuara nga ana e Kontributit.

7.2 Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për ndonjë situatë që ndërhyn ose rrezikon të ndërhyjë në përmbushjen e qëllimit të Kontributit, ose në performancën e secilës prej tyre, si dhe në detyrimet e tyre në MP.

7.3 Palët Kontraktuese duhet të mbajnë regjistra dhe dosje të veçanta në lidhje me zbatimin e Projektit dhe përdorimin e Kontributit. Ato duhet të mbajnë, gjithashtu, të gjitha dokumentet në lidhje me MP-në dhe zbatimin e saj për dhjetë vjet pas përfundimit të Projektit.

7.4 Do të kryhen auditime financiare sipas Politikës Financiare të Auditimit të SECO-s në mes dhe në fund të Projektit, në çdo rast jo më vonë se tre vjet pas fillimit të MP-së.

7.5 SECO-ja mund të organizojë në çdo kohë misione inspektimi për të garantuar zbatimin efikas të Projektit, dhe përdorimin e Kontributit, si dhe arritjen e objektivave të tyre.

7.6 MEI pas përfundimit të Projektit, megjithatë, jo më vonë se katër muaj pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, duhet t'i japë SECO-s një raport me një objekt të tillë dhe me aq detaje sa ky i fundit në mënyrë të arsyeshme do t'i kërkojë për zbatimin e Projektit dhe për përmbushjen e qëllimit të Kontributit.

Neni 8
Klauzola antikorrupsion

Palët Kontraktuese ndajnë të njëjtin shqetësim në luftën kundër korrupsionit, i cili vë në rrezik qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve të nevojshme për zhvillim dhe, për më tepër, rrezikon konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi. Si rrjedhojë, ato deklarojnë qëllimin e tyre për të bashkuar përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe, në veçanti deklarojnë se çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim apo përfitim i çdolloji, i dhënë nga kushdo, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me synimin për të marrë një mandat apo kontratë brenda kuadrit të MP-së ose gjatë zbatimit të saj, do të interpretohet si një veprim i paligjshëm ose praktikë korrupsioni. Çdo veprim i kësaj natyre përbën arsye të mjaftueshme për të justifikuar anulimin e MP-së, prokurimit ose të fitimit të rezultatit, ose

për të marrë ndonjë masë tjetër korrigjuese të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

Neni 9

Baza e bashkëpunimit

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat themelore të njeriut, siç janë përcaktuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, janë baza e politikave vendore të Palëve Kontraktuese dhe përfaqësojnë një element thelbësor po aq të rëndësishëm sa edhe objektivat e MP-së.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Mosmarrëveshjet në lidhje me inter-pretimin ose zbatimin e dispozitave të MP-së, të cilat nuk janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme me anë të bisedimeve zyrtare brenda një periudhe kohe prej tre muajsh që nga data kur janë ngritur nga një Palë Kontraktuese, me kërkesë të SECO-s ose të MEI-t, do të paraqiten në një gjykatë arbitrazhi të përbërë prej tre anëtarësh. SECO-ja dhe MEI, secili do të caktojnë nga një arbitër. Të dy arbitrat e caktuar do të caktojnë një arbitër të tretë si Kryetar, i cili do të jetë shtetas i një vendi të tretë.

10.2 Nëse njëra Palë nuk ka caktuar arbitrin e saj dhe nuk ka ndjekur ftesën e Palës tjetër për të bërë caktimin brenda një muaji, arbitri i dytë do të caktohet me kërkesë të Palës ftuese nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

10.3 Nëse të dy arbitrat nuk mund të bien dakord për caktimin e një arbitri të tretë (Kryetari) brenda dy muajve pas caktimit të tyre, ky i fundit do të caktohet me kërkesën e çdonjërës nga Palët nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

10.4 Nëse në rastet e përcaktuara në dispozitat 10.2 dhe 10.3, Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pengohet për të përmbushur funksionin e përmendur, ose nëse ai/ajo është shtetas i ndonjërës prej Palëve, caktimi do të bëhet nga zëvendëskryetari, dhe nëse ky i fundit ndalohet, ose nëse ai/ajo është shtetas i ndonjërës prej Palëve, caktimi do të bëhet nga Gjykatësi tjetër i lartë në Gjykatë, i cili nuk është shtetas i asnjërës prej Palëve.

10.5 Legjislacioni i zbatueshëm është legjislacioni zviceran. Vendndodhja e gjykatës së arbitrazhit duhet të jetë në Konfederatën Zvicerane.

10.6 Në varësi të dispozitave të tjera të bëra nga Qeveria Zvicerane ose nga Qeveria e Shqipërisë, gjykata e arbitrazhit do të caktojë procedurën e saj.

10.7 Vendimet e gjykatës së arbitrazhit do të jenë të detyrueshme për secilën Palë Kontraktuese.

Neni 11

Modifikime ose ndryshime, anekset

11.1 Çdo modifikim apo ndryshim i MP-së, i bërë nga Palët Kontraktuese sipas kësaj MP-je, duhet të bëhet vetëm me shkrim dhe siç është rënë dakord me konsensus nga Palët Kontraktuese.

11.2 Anekset e mëposhtme janë pjesë integrale e kësaj MP-je:

11.2.1 Aneksi 1: Koncepti i Projektit

11.2.2 Aneksi 2: Kuadri logjik

11.2.3 Aneksi 3: Buxheti i Projektit

11.2.4 Aneksi 4: Arritjet e Projektit

11.2.5 Aneksi 5: Versioni i ndryshuar i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1081 dhe urdhrit të ministrit të Industrisë dhe Energjisë nr. 158.

11.2.6. Aneksi 6: Udhëzimet mbi Prokurimet të SECO-s

11.3 Modifikimet ose ndryshimet e anekseve të MP-së mund të bëhen me shkrim në nivelin e duhur teknik me pëlqimin e SECO-s, MF-së dhe MEI-t.

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

12.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit dhe marrjes së njoftimit përkatës nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i cili ka përmbushur të gjitha procedurat e brendshme ligjore që janë në përputhje me kuadrin përkatës ligjor në fuqi. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri kur të jenë përmbushur të gjitha detyrimet e saj, e llogaritur për datën 31 dhjetor 2019.

12.2 Megjithatë, nëse njëra nga Palët ose tjetra gjykon se para përfundimit të MP-së, qëllimet e saj nuk mund të arrihen më, ose që Pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, ajo do të ketë të drejtën të anulojë ose të përfundojë MP-në në çdo kohë, duke dhënë një njoftim me shkrim gjashtë muaj para. Pavarësisht nga

sa më sipër, çdonjëra nga Palët, me njoftim me shkrim për arsyet, mund të përfundojë MP-në me efekt të menjëhershëm në rast të ndonjë shkeljeje të konsiderueshme të MP-së. Shkelje e konsiderueshme nënkupton çdo shkelje të rëndë të njërit prej objektivave kryesorë të MP-së apo shkelje të rëndë të detyrimeve të Palëve Kontraktuese.

12.3 Në rast të përfundimit të MP-së, sipas nenit 12, paragrafi 2, dispozitat e MP-së do të vazhdojnë të zbatohen për të gjitha kontratat që janë në vazhdim në kohën e përfundimit të saj, deri kur të kenë përfunduar kontratat përkatëse.

Neni 13
Baza ligjore

Marrëveshja Kuadër dhe Udhëzimet e Prokurimit të SECO-s përbëjnë pjesë integrale të MP-së. Në rast mosmarrëveshjesh në përmbajtje, MP-ja do të ketë përparësi. Si shtesë, zbatohet legjislacioni zviceran.

Neni 14
Gjuha

E gjithë korrespondenca me SECO-n përfshirë çdo lloj dokumenti, miratim faturash, raporte dhe dokumente të tjera në lidhje me Projektin do të përgatiten në gjuhën angleze.

Neni 15
Përgjegjësitë

SECO-ja nuk merr përsipër ndonjë rrezik apo përgjegjësi për dëme, dëmtime apo efekte të tjera të mundshme të pafavorshme të shkaktuara nga Projekti, përfshirë, por pa u kufizuar te mospërputhjet e planifikimit të Projektit, projektit/projekteve të tjera që mund të ndikojnë mbi të, apo të shkaktojnë pakënaqësi te publiku.

Hartuar në Tiranë, më _____, 2015, në katër kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjeje në interpretimin apo në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje Projekti, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Shqipërisë:
.....
Ministria e Energjisë dhe Industrisë

SH.T. Damian Gjiknuri
Ministër
.....

Ministria e Financave

SH.T. Shkëlqim Cani
Ministër

Për Qeverinë Zvicerane:
.....
Ambasada Zvicerane

SH.T. Christoph Graf
Ambasador

Anekset:
1. Koncepti i Projektit
2. Kuadri logjik
3. Buxheti i Projektit
4. Arritjet
5. Vendimi i ndryshuar i Këshillit të Ministrave nr. 1081 dhe urdhri i ministrit të Industrisë dhe Energjisë nr. 158.
6. Udhëzimet mbi Prokurimet të SECO-s

ANEKSI 1

PROJEKTI PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ZHVILLIMET NË PËRMASA TË MËDHA TË INFRASTRUKTURËS SË GAZIT NË SHQIPËRI II: KONCEPTPROJEKTI

1. Informacion paraprak

Me gjithë progresin e bërë në vitet e fundit, Shqipëria përballet me problematika të rëndësishme në sektorin energjetik. Siguria e furnizimit me energji mbetet veçanërisht e dobët për shkak të mungesës së diversifikimit. Kërkesa për energji elektrike tejkalon prodhimin vendës që varet pothuajse vetëm nga prodhimi i energjisë hidrike, ku moti luan një rol thelbësor. Mangësitë në furnizim plotësohen me energji të kushtueshme bazuar në hidrokarbure fosile, e cila është e shtrenjtë dhe që importohet nga vendet fqinje ose edhe me përdorimin e gjeneratorëve vendorë me naftë. Zhvillimi i biznesit është i kufizuar nga mungesa e herëpashershme e energjisë, çmimet e larta të energjisë elektrike dhe pengesat admini-strative në lidhje me furnizimin me energji elektrike.

Konsorciumi i Shah Deniz II, me përzgjedhjen[1] e tij të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) si rrugën e parapëlqyer për transportin e gazit natyror azerbajxhanas për në Evropën Perëndimore, ka hapur rrugën për hapjen e mëtejshme të Korridorit Jugor të Gazit. Nëpërmjet TAP-it, Shqipëria do të lidhet me rrjetin ndërkombëtar të gazsjellësve. Kërkesa paraprake dhe skenarët për investime në tregun dhe infrastrukturën e ardhshme shqiptare të gazit përbëjnë mundësi të rëndësishme ekonomike për ekonominë shqiptare.

Megjithatë, analizat tregojnë nevojën e madhe të Qeverisë së Shqipërisë për ngritjen e kapaciteteve shtesë për përballimin e projekteve të rëndësisë së lartë siç është TAP-i, si dhe për trajtimin e zhvillimit të mundshëm të një tregu të ri gazi në vend. Si rrjedhojë, SECO-ja do të mbështesë Qeverinë e Shqipërisë në lidhje me Projektin për Ngritjen e Kapaciteteve për Zhvillimet në Përmasa të Mëdha të Infrastrukturës së Gazit në Shqipëri II, duke trajtuar në mënyrë të veçantë nevojat menaxheriale, teknike, ato specifike financiare dhe ligjore për industrinë dhe strukturore të ngritjes së kapaciteteve dhe forcimit të nevojave institucionale, si dhe duke i mundësuar Qeverisë së Shqipërisë të realizojë përfitimet e mundshme që rrjedhin nga zbatimi i TAP-it dhe zhvillimi i një tregu shqiptar gazi.

2. Përshkrimi i Projektit

2.1 Ndikimi, rezultatet e Projektit

Ndikimet e projektit në fjalë përfshijnë rritjen e sigurisë së energjisë nëpërmjet diversifikimit të energjisë, zhvillimin ekonomik përmes një kuadri më të qëndrueshëm investimi dhe zvogëlimin e shkarkimit të gazrave që ndikojnë në efektin serrë, duke ulur importimin e energjisë së prodhuar nga burime fosile. Rezultatet e pritshme të Projektit janë hapja dhe zhvillimi i tregut vendor të gazit në Shqipëri, rritja dhe përditësimi i kuadrit ligjor, teknik dhe institucional për zhvillimin e sektorit të gazit në përputhje me direktivat e BE-së dhe qeverisja e përmirësuar e projekteve të infrastrukturës që do të realizohen në kuadrin e zbatimit të Projektit TAP dhe krijimit të tregut shqiptar të gazit (shihni kuadrin logjik në shtojcën 2).

2.2 Shërbimet e këshillimit dhe të ngritjes së kapaciteteve për arritjen e synimeve të Projektit

Për arritjen e ndikimeve dhe rezultateve të sipërpërmendura, Projekti do t'i ofrojë Qeverisë së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera të përfshira, mbështetje të gjerë dhe institucionale për ngritjen e kapaciteteve. Shërbimet e këshillimit dhe të ngritjes së kapaciteteve do të realizohen nga Konsulenti që mbulon kompetencat për forcimin e sektorit publik, si këshilltarë të qeverisë në lidhje me projektet madhore në infrastrukturë, me zhvillimin e tregut të gazit dhe strategjitë e sektorit të energjisë në lidhje me aspektet teknike inxhinierike dhe ato financiare e rregullatore, si dhe në komunikim dhe në përfaqësim.

Mbështetja e Konsulentit do të fokusohet në tri lloje ndërhyrjesh:

1. Shërbimet këshilluese: Veçanërisht gjatë fazës fillestare dhe fazës së studimit të projektit, Konsulenti do t'u ofrojë ndihmë të drejtpërdrejtë teknike institucioneve të qeverisë dhe autoriteteve publike të përfshira. Kjo do t'i mbështesë ata në kryerjen efikase dhe të shpejtë të funksioneve të tyre për realizimin e TAP-it dhe fillimin e zhvillimit të tregut të gazit. Pjesa e shërbimeve të këshillimit brenda të gjithë mandatit ka gjasa të zvogëlohet gjatë zhvillimit të Projektit.

2. Ngritja e kapaciteteve: Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së Projektit, Konsulenti do të përqendrohet në forcimin e kompetencave të institucioneve publike të përfshira, si dhe stafit kyç të qeverisë të përfshirë në zbatimin e TAP-it dhe zhvillimin e tregut shqiptar të gazit. Ndërhyrjet e ngritjes së kapaciteteve do të përfshijnë si masa afatshkurtra, të tilla si trajnimi gjatë punës, ashtu edhe masa afatgjata si ngritje sistematike

[1] Konsorciumi Shah Deniz njoftoi vendimin e tij, më 28 qershor 2013, ku deklarohej se TAP-i ishte përzgjedhur si rruga e parapëlqyer gazsjellëse për transportimin e gazit azerbajxhanas në Evropë. Aksionerët e TAP-it konfirmuan, më 17 dhjetor 2013, rezolutën për zhvillimin dhe ndërtimin e Projektit TAP.

dhe e formalizuar kapacitetesh dhe transferim njohurish nëpërmjet instrumenteve, procedurave dhe strukturave organizative të nevojshme.

3. Planifikimi dhe monitorimi: Konsulenti do të hartojë planet e përgjithshme të punës për ngritjen e kapaciteteve dhe do të monitorojë zbatimin e të gjitha aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në përputhje me kuadrin logjik në shtojcën 2.

Konsulenti do të ofrojë shërbimet e tij për një auditues të përcaktuar dhe të synuar që do të përbëhet nga: i) stafi kyç në ministritë e përfshira me zbatimin e TAP-it dhe gazifikimin e Shqipërisë; ii) një grup nëpunësish civilë të caktuar nga ministritë e linjës në Grupin Teknik të Ekspertëve (GTE); iii) NJKP-ja; dhe iv) instituti i naftës dhe të gazit, sapo të jetë krijuar nga autoritetet shqiptare.

2.3 Aktivitetet dhe rezultatet e pritshme

Projekti i ngritjes së kapaciteteve është i strukturuar në formën e gjashtë proceseve /procedurave të punës nga të cilat një pjesë synon ngritjen e kapaciteteve teknike në lidhje me infrastrukturën e gazit, ndërsa pjesa tjetër synon ngritjen e kapaciteteve menaxheriale. Synimet e procedurave të punës shpjegohen më poshtë.

Procedura e punës	Synimi
Kapacitetet teknike në lidhje me infrastrukturën e gazit	
Procedura e punës 1: Strategjia dhe politikat e sektorit	Synimi i procedurës së punës 1 është të mbështesë MEI-n dhe t'u bëjë të mundur anëtarëve të GET-së të hartojnë dokumentet e politikës dhe strategjisë për sektorin energjetik (Strategjia për energjinë, Studimi për zhvillimin e tregut të gazit, masterplani i gazit). GTE-ja në bashkëpunim me ERE-n dhe aktorë të tjerë të sektorit publik të hidrokarbureve, duhet të hartojë analiza të ndikimit të politikave në sektorin e sapozhvilluar të gazit natyror, analiza ekonomike të tregjeve të energjisë, analiza për mundësitë e ndryshimit të klimës për infrastrukturën gjatë procedurës bazuar në tregun e ardhshëm të gazit në Shqipëri, si dhe analiza ligjore të legjislacionit të propozuar dhe rregulloreve që ndikojnë si te TAP-i, ashtu edhe në tregun e gazit.
Procedura e punës 2: Legjislacioni dhe lejet	Ky modul i Projektit ngre kapacitetet për kryerjen sistematike dhe të shpejtë të veprimtarive të nevojshme për të negociuar dhe për të finalizuar marrëveshje të hapura me TAP (Marrëveshja e qeverisë së vendit pritës MQVP, Marrëveshja referuese, Marrëveshja mbi përfitimet vendore, Marrëveshja për zhvillimin e tregut të gazit), për përgatitjen për ndërtimin e TAP-it, si dhe infrastrukturës tjetër të tregut të gazit gjatë procedurës për përmirësimin e kuadrit ligjor, teknik dhe institucional për zhvillimin e sektorit të gazit shqiptar (në përputhje me direktivat e BE-së, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare shoqërore, mjedisore, të sigurisë dhe teknike, dhënien e licencimit për leje, operim dhe procedurat për përgatitjen e projektit). Proceset e lejeve dhe të licencimit ligjor për TAP-in dhe projektin vendor të infrastrukturës së gazit duhet të promovohen prej GTE-së nëpërmjet autoriteteve përkatëse (të tilla si ERE). GTE-ja, në bashkëpunim me ERE-n, duhet të japë kontribut për hartimin e strukturës tarifore të gazit për tregun shqiptar të gazit. Kur të jenë lëshuar lejet për TAP dhe projekte të tjera infrastrukture, procedurat e blerjes dhe servitutit të tokës duhet të monitorohen dhe të shoqërohen nga qeveria (nëpërmjet GTE-së) dhe strukturat ekzekutive në çdo ministri, duke ndjekur procedurat standarde.
Procedura e punës 3: Përfshirja gjatë zhvillimit të projektit	Synimi i procedurës së punës 3 është të ngrejë kapacitete për një përfshirje gjatë zhvillimit e projektit, pra të krijojë një grup të përhershëm mbështetës për investimet madhore dhe projektet e infrastrukturës së gazit. GTE, ERE dhe pjesëmarrës të tjerë në sektorin publik të hidrokarbureve do të duhet të ngrenë kapacitete për hartimin dhe shqyrtimin e planeve të biznesit për verifikimin e nënprojekteve të gazifikimit, pra ato që lidhen me infrastrukturën e tregut të gazit në rrjedhën e poshtme, të tilla si studimi i fizibilitetit për të lidhur Termocentralin e Vlorës me pikën e daljes së TAP-it në Fier. MEI, GTE dhe agjenci të tjera të përfshira në zhvillimin e sektorit të gazit, duhet të jenë të afta të ndihmojnë investitorët vendës për projektet individuale të investimit.
Procedura e punës 4: Ngritja e institucioneve	Synimi i procedurës së punës 4 është të ngrejë kapacitetet për nxitjen dhe mbështetjen efikase për krijimin e mundshëm të institucioneve të reja, të tillë si instituti i naftës dhe gazit ose zhvillimi organizativ i institucioneve ekzistuese kyçe, të cilat do të kenë një rol thelbësor në zhvillimin e tregut shqiptar të gazit, si Enti Rregullator i Energjisë, ERE, Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST, si dhe mundësisht edhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, OSSH. GTE-ja, në

	bashkëpunim me strukturat përkatëse të MEI-t, do të duhet të ideojnë ose të zhvillojnë më tej përkufizimin e rolit të këtyre aktorëve, përgjegjësitë dhe misionet e tyre, si edhe strukturat e tyre vepruese dhe ligjore, duke marrë në konsideratë kontekstin shqiptar.
Kapacitetet menaxhuese	
Procedura e punës 5: Koordinimi dhe zbatimi	Procedura e punës 5 synon ngritjen e kapaciteteve dhe mundëson GTE ndërministror dhe NJKP-në të përmbushin rolet e tyre si zyrë e menaxhimit të projektit dhe si njësi ofertuese brenda MEI-t që siguron koordinimin dhe zbatimin brenda afateve të të gjitha veprimtarive qeveritare në fushën e zbatimit të TAP-it dhe zhvillimit të tregut shqiptar të gazit. GTE-ja do të ngarkohet me bashkërendimin e veprimtarive, si edhe me menaxhimin e proceseve në të gjitha ministritë dhe agjencitë e përfshira me projektin TAP dhe gazifikimin e Shqipërisë.
Procedura e punës 6: Komunikimi dhe përfaqësimi	Procedura e punës 6 do të ngrejë kapacitetet për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm me rritjen e aftësive dhe njohurive për përfaqësimin e qeverisë së Shqipërisë në kuadrin e TAP-it dhe të gazifikimit të vendit. Një hap i tillë kërkon përkufizimin e audituesit të synuar, kanaleve, parimeve të komunikimit dhe mesazheve, si edhe buxhetin, dhe më pas zbatimin e veprimtarive të komunikimit me anë të mjeteve të ndryshme, përfshirë kurset e trajnimit për anëtarët e GTE-së dhe pjesëmarrjen në konferenca ku GTE-ja prezanton zbatimin e TAP-it dhe zhvillimin e tregut të gazit.

2.4 Përfituesit

Përfituesit e drejtpërdrejtë të Projektit të ngritjes së kapaciteteve janë institucionet e ndryshme në qeverinë shqiptare, veçanërisht ministritë, dhe kryesisht Ministria drejtuese e Energjisë dhe Industrisë (MEI), Sektori i Politikave dhe Zhvillimit të Gazit Natyror pranë Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve në MEI, NJKP-ja, si dhe agjencitë dhe institucione të tjera publike që kanë rol në zhvillimin e tregut shqiptar të gazit përmes projektit të gazsjellësit TAP. Institucione të tjera publike që përfitojnë nga projekti i ngritjes së kapaciteteve janë Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Autoriteti Kombëtar i Planifikimit të Territorit (AKPT), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Inspektorati Qendror Teknik, institucionet akademike në sektorin e hidrokarbureve që pritet të krijohen, si dhe institucione të tjera (gjysmë) publike në sektorin e hidrokarbureve, si Albpetroli.

Si rezultat i mundësive të rëndësishme ekonomike, e gjithë popullata shqiptare do të përfitojë nga ndikimet dhe rezultatet e Projektit në përfundim të tij.

3. Organizimi dhe Koordinimi

Mbështetja e Konsulentit do të drejtohet ndaj "Task Forcës" të sapokrijuar të përbërë nga përfaqësues të ministrive shqiptare të përfshira dhe nga institucione të tjera përkatëse[1]. Task Forca ka një nivel politik vendimmarrjeje dhe bashkërendimi politikash, si edhe një përgjegjësi në nivel teknik për detyrat operative në lidhje me gazifikimin. Kjo njësi është krijuar nga Qeveria Shqiptare në janar të vitit 2014. Niveli politik është një "Komision ndërinstitucional" i krijuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, më 18 dhjetor 2013, ndërsa niveli teknik është "Grupi teknik i ekspertëve" (GTE) ose "Sekretariati Teknik" që është krijuar nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, më 3 prill 2014.

[1] Përfshirë: Autoritetin Rregullator të Energjisë në Shqipëri (ERE), Autoritetin Kombëtar të Planifikimit të Territorit AKPT, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore AKBN, Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit dhe Investimit AIDA, si dhe pjesëmarrësit e gazit natyror dhe institucionet publike.




Figura: Task Forca

(Me korniza të errëta: Ministria e Energjisë dhe Industrisë do të drejtojë Komisionin Ndërinstitucional dhe GTE.)

Komisioni Ndërinstitucional është një organizëm politik që merr vendime strategjike dhe mbështet institucionet ose struktura të tjera qeveritare për zbatimin e hapave të nevojshëm për realizimin e TAP-it dhe zhvillimin e tregut shqiptar të gazit nga ministritë dhe agjencitë e tjera. Komisioni përbëhet nga zëvendësministrat e ministrive të linjës dhe nga përfaqësuesit e drejtorive.

Grupi Teknik i Ekspertëve GTE është organizmi veprues dhe koordinues që drejton në emër të MEI-t, zbatimin e projektit TAP-it dhe veprimtaritë e ndërmarra për zhvillimin e tregut shqiptar të gazit. Anëtarëve do t'u caktohen dy detyra:

i) ata janë përgjegjës për bashkërendimin e progresit të dosjeve në lidhje me institucionet e tyre në kuadër të zbatimit të TAP-it dhe zhvillimit të tregut shqiptar të gazit; dhe

ii) ata do të veprojnë si "agjentë shkëmbimi" për shumëfishimin e ndikimit të ngritjes së kapaciteteve përtej vetë Task Forcës. Ata do të mbështesin Konsulentin në transmetimin e njohurive në institucionet e veta. Mënyrat e kalimit horizontal të njohurive nga Task Forca për në ministritë e linjës dhe agjencitë do të përcaktohen nga GTE-ja nën udhëzimin e Konsulentit.

Koordinimi i Projektit do të menaxhohet nga Njësia e Koordinimit të Projektit (NJKP) e vendosur pranë MEI-t dhe e ngarkuar me ekzekutimin operativ të projektit (tenderimin, monitorimin, raportimin, proceset administrative, menaxhimin e kontratës).

4. Monitorimi i Projektit

Komiteti Drejtues, i përbërë nga përfaqësues të Ambasadës Zvicerane, MEI dhe Ministria e Financave, do të ofrojë drejtim dhe mbështetje për zbatimin e suksesshëm të veprimtarive të projektit dhe arritjen e rezultateve të pritura, si dhe do të krijojë frymën e transparencës dhe do të mbështesë pronësinë e projektit për të gjitha palët kryesore të interesit. Komiteti Drejtues drejtohet nga MEI. Palët e tjera të interesit mund të ftohen në Takimet e Komitetit Drejtues pa të drejtë vote.

NJKP-ja do të hartojë raporte dy herë në vit ndërsa Konsulenti do të hartojë raporte tremujore mbi progresin e projektit.

SECO-ja dhe MEI do të mbështeten nga Mbështetësit në fushat e mëposhtme: i) për përgatitjen e termave të referencës për tenderin dhe vlerësimin e tenderëve të Konsulentit; dhe ii) për vlerësimin e raportit fillestar dhe raportet e NJKP-së dhe Konsulentit. Në përfundim të projektit, mbështetësit do të hartojnë një raport përfundimtar mbi rezultatet e Projektit.

ANEKSI 2
KUADRI LOGJIK

(Kuadri logjik mund të ndryshojë gjatë përgatitjes së raportit fillestar të Projektit dhe do të përqendrohet në disa tregues/indikatorë kritikë në variantin e tij përfundimtar.)

Kapacitetet e infrastrukturës së gazit

Kapacitetet menaxheriale:

1. Strategjitë dhe politikat sektoriale;
- Analiza (efekti i politikave, tregu);
- Politika për ndryshimet klimatike;
- Zhvillimi i objektivave;

- Synimi i studimit të fizibilitetit dhe të Masterplanit të Gazit;
- Programi i politikave dhe i zhvillimit të legjislacionit.

2. Rregullore/lejet:
- Kuadri ligjor (HGA,IGA);
- Rregullore/lejet;
- Struktura tarifore e Shqipërisë;
- Përdorimi dhe blerja e tokës;
- Kuadri i përgjithshëm i investimeve.

3. Konfigurim i zhvillimit të projektit:
- Miratimi i planit të biznesit për (në) projektet për gazifikimin;
- Identifikimi i projekteve për ndryshimet klimatike;
- Mbështetja për negociatat e marrëveshjeve për ndarjen e detyrimeve për investitorët potencialë;
- Mbështetja për krijimin e SPV-ve të projektit nga ana e shtetit;
- Mbështetja për mobilizimin e financave /investimeve.

4. Zhvillim i institucioneve:
- Agjencia e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)**;
- Mbështetje nga ERE
- Mbështetje për krijimin e TSO/DSO-së**;
- Mbështetje për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në lidhje me drejtimin e sektorit të gazit natyror.

5. Koordinim/implementim:
- Koordinim dhe menaxhim i proceseve në Ministri;
- Përkufizim i procesit të KPI-ve në tërësi;
- Monitorim dhe raportim;
- Mbështetje ndaj prokurimeve;
- Mbikëqyrje e implementimit.

6. Komunikim/prezantim:
- Strategji komunikimi;
- Aftësi negocimi;
- Dialogu me aktorët/palët e interesuara;
- Menaxhim i hetimit publik;
- Përfaqësim ndërkombëtar dhe i BE-së.

Ngritja e kapaciteteve për zhvillimet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit	**Shqipëri**	**2014-03-25/569**	
Strategjia e ndërhyrjes	**Treguesit kyçë të performancës**	**Mënyrat e verifikimit**	**Faktorë të jashtëm (presupozimet/ rreziqet)**
Ndikimi	**Treguesit e ndikimit**		
- Rritet siguria e energjisë - Zhvillim ekonomik përmes një kuadri më të qëndrueshëm investimi - Ulje e shkarkimeve të gazrave serë	- Numri rasteve të mungesave të energjisë në vit (shërbim publik i përmirësuar) - Numri i personave me furnizim të përmirësuar me energji (ndarë sipas rajoneve)[1] - Vlerësimi i Bankës Botërore "Të bësh biznes" [Doing Business Ranking] - Hyrjet e investimeve të huaja direkte dhe krijimi i mundësive për punë - Ritje e prodhimit të brendshëm bruto; Ulje e shkarkimeve CO_2 pas gazifikimit të Shqipërisë (si rrjedhojë e uljes së importit të energjisë prodhuar me karburante fosile)[2]	- Statistikat e energjisë së KESH-it, statistikat e ERE-s dhe nënstatistikat e Bankës Botërore në kuadër të "Të bësh biznes" - - Statistikat makroekonomike të FMN-së, Bankës Botërore, OECD-së etj. - Analizë prapavepruese e shkarkimeve të gazrave serë 8 vjet pas përfundimit të	- Kushte të njëjta për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë - Stabilitet politik dhe makroekonomik

[1] Zëvendësues për treguesin standard.
[2] Tregues standard.

		projektit	

Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyçë të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorë të jashtëm (presupozimet/ rreziqet)
Rezultatet	**Treguesit e rezultateve**		
Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit - Fillimi i Gazifikimit të Shqipërisë dhe zhvillimi i një tregu shqiptar të gazit, si dhe rritja dhe përditësimi i kuadrit ligjor, teknik dhe institucional për zhvillimin e sektorit të gazit në përputhje me direktivat e BE-së. **Kapacitetet menaxheriale** - Qeverisje e përmirësuar e projekteve infrastrukturore	**Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit** - Ratifikimi i Strategjisë për Sektorin Energjetik - Ratifikimi i Studimit të Tregut të Gazit dhe Master Planit për Infrastrukturën e Gazit - Miratimi i kuadrit ligjor, teknik dhe institucional për sektorin e gazit në përputhje me direktivat e BE-së - Planet e biznesit për projektet e infrastrukturës në rrjedhën e poshtme janë në zbatim Qartësohen përgjegjësitë dhe rolet e OST-së, OSSH-së, ERE-s, Albpetrol dhe AIDA-s në kontekstin e gazifikimit të Shqipërisë **Kapacitetet menaxheriale** - Kryhen proceset ndër institucionale dhe organizohet menaxhimi i projekteve të infrastrukturës madhore të gazit - Zbatohen dhe aplikohen proceset e dorëzimit në rast ndryshimi personeli - Ministritë dhe institucionet e linjës së gazit përdorin instrumentet dhe modelet përkatëse - Zbatohen Tregues Kyç të Performancës (TKP) për realizimin e TAP-it dhe zhvillimin e tregut shqiptar të gazit - Ngrihen kapacitetet e NJKP-së në lidhje me menaxhimin e projektit, hartimin e proceseve dhe negocimin e kontratave	**Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit** - Deklaratat e ratifikimit nga Këshilli i Ministrave - Progres Raportet e BE-së - Raportet për zbatimin e planeve të biznesit për projektet e infrastrukturës - Normat dhe informacione statutore në lidhje me tregun e gazit për OST-në, OSSH-në, ERE-n dhe AIDA-n. **Kapacitetet menaxheriale** - Pronarët e caktuar të proceseve, përshkrimet e proceseve dhe organigramat - Kurrikulat e trajnimit iu bashkëngjiten ministrive dhe aplikohen - Takime dhe shënime mbi dorëzimet Përdoren instrumente dhe modele për projektet në vazhdim - Progresraporte për zbatimin e projektit duke pasqyruar TKP-në - Kontrata projekti të hartuara në mënyrë të pavarur - Aplikim i proceseve të menaxhimit të projektit	- Stabilitet politik dhe makroekonomik - Kushtet kuadër për TAP-in mbeten të pandryshuara - Interes i vazhdueshëm nga komunitetet ndërkombëtare të donatorëve dhe investitorëve për përditësimin e infrastrukturës shqiptare

Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyçë të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorë të jashtëm (presupozimet/rreziqet
Rezultatet	**Treguesit e rezultateve**		
Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit - Procedura e punës (RP) 1:	**Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit** - RP 1: Paraqitja e një	**Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit** - RP 1: Variantet e fundit draft	- Rreziqet e projektit TAP jashtë kontrollit të Shqipërisë, të tilla si lidhja e suksesshme

Analizë ekonomike e tregjeve energjetike - RP 1: Strategji e re për sektorin energjetik në Shqipëri 2015—2030 - RP 1: Përpunimi i strategjisë së sektorit të gazit - RP 1: Krijimi i kuadrit ligjor dhe rregullator i favorshëm për zhvillimin e sektorit të gazit në përputhje me direktivat e BE-së RP 1: Dokument politikash mbi ndryshimet klimaterike	Strategjie të re për Sektorin e Energjisë, - RP 1: Strategjia për sektorin e gazit - RP 1: Studimi i fizibilitetit të tregut të gazit - RP 1: dhe një Masterplan për Infrastrukturën e Gazit si dokumente udhëzuese politikash - RP 1: Miratimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për sektorin e gazit - RP 1: Paraqitje e dokumentit të politikave që shënjon mundësitë për ndryshime klimaterike bazuar në zhvillimin e tregut të gazit - RP 1: Paraqitje e planit të uljes së shkarkimeve të gazrave serrë bazuar në gazifikimin e Shqipërisë	të Strategjisë së Energjisë, fizibilitetit të tregut të gazit dhe Master Planit të Infrastrukturës së Gazit janë të disponueshme	me TANAP-në në Turqi, fillimi në kohë i veprimtarisë i Shah Deniz në Azerbajxhan, zbatimi i TAP-it në Greqi etj. - Rreziqe politike brenda Shqipërisë, veçanërisht ato të lidhura me rezultatet zgjedhore të zgjedhjeve vendore dhe vendore gjatë kohëzgjatjes së projektit - Kontribute në kohë nga qeveria shqiptare. Përmbushja e arritjeve të suksesit (shihni aneksin 4). - Mundësimi i stafit kyç qeveritar për Task Forcën, por gjithashtu edhe në nivel ministrie (pronësi, burime).
- RP 2: Përfundimi i marrëveshjeve të hapura me konsorciumin e TAP-it - RP 2: Përfundimi i kuadrit ligjor të investimeve për TAP-in në përputhje me standardet shoqërore, mjedisore dhe të sigurisë - RP 2: Promovim i proceseve të lejeve dhe licencimit për TAP-in dhe projektet e brendshme të infrastrukturës së gazit - RP 2: Hartimi i strukturës tarifore të gazit për tregun e gazit në Shqipëri - RP 2: Monitorim i procedurave të blerjes dhe servitutit të tokës - RP 2: Mbështetja për miratimin dhe zbatimin e rregullave të DVGW-së në ligjin shqiptar	- RP 2: Ratifikim në kohë i të gjitha Marrëveshjeve me Projektin dhe ndryshimeve të MQVP-së - RP 2: Miratimi në kohë i kuadrit ligjor të investimeve për TAP-in - RP 2: Përcaktohen procedurat për lejet dhe licencimet ligjore - RP 2: Miratimi i strukturës tarifore të gazit nga ERE - RP 2: Përcaktohen proceset dhe procedurat për blerjen dhe servitutin e tokës - RP 2: Zbatimi i rregullave të DVGW-së	- RP 2: Deklarata miratimi nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë - RP 2: Përshkrime procesesh dhe raporte për veprimtaritë e trajnimit mbi proceset	
- RP 3: Shqyrtim dhe hartim planesh biznesi për kryerjen e verifikimeve të nënprojekteve të gazifikimit - RP 3: Identifikim i projekteve përkatëse për ndryshimet klimaterike - RP 3: Përgatitja e TR për studimin e fizibilitetit për të lidhur Termocentralin e Vlorës me pikën e daljes së TAP në Fier	- RP 3: Numri dhe cilësia e planeve të biznesit të hartuar për projektet infrastrukturore të gazit në rrjedhën e poshtme (veçanërisht projektet e testimit të ngarkesës - RP 3: Paraqitje e planeve të biznesit të nivelit të lartë për projekte përkatëse për ndryshimet klimaterike - RP 3: TR të përfunduara për studimin e fizibilitetit	- RP 3: Shqyrtim i planeve të biznesit	
- RP 4: Kapaciteti i Task Forcës për konceptimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të përkufizimit të roleve të autoritetit rregullator ERE, OST dhe OSSH dhe politikë-bërësve përkatës (pra MEI) si dhe agjencia për promovimin e investimeve AIDA dhe një institut i mundshëm i ardhshëm i naftës dhe gazit.	- RP 4: Janë të disponueshme përshkrimet e fundit draft për rolet e reja dhe ndryshimet organizative të ERE-s, OST-së, OSSH-së, AIDA-s dhe një institut i mundshëm i ardhshëm i naftës dhe gazit	- RP 4: Shqyrtim i dokumentacionit	

Kapacitetet menaxheriale - RP 5: Kapaciteti (aftësitë) i Task Forcës për të drejtuar koordinimin operativ dhe menaxhimin e proceseve në ministritë dhe agjencitë e përfshira me projektin TAP dhe gazifikimin e Shqipërisë - RP 5: Kapaciteti (aftësitë) i Task Forcës për të përcaktuar TKP-në për të gjitha proceset dhe institucionet e përfshira në proceset e realizimit të TAP-it dhe, gjithashtu, për të mbështetur nga ana e Qeverisë prokurimet e veçanta të projekteve individuale - RP 6: Kapaciteti (aftësitë) i Task Forcës për të drejtuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe përfaqësimin e qeverisë shqiptare në kuadrin e TAP-it dhe gazifikimit të vendit	**Kapacitetet menaxheriale** - RP 5: Realizimi i trajnimeve në ministri ose në institucionet qeveritare dhe agjencitë publike të përfshira në sektorin e gazit në përputhje me planin vjetor të punës (numri i aktiviteteve të planifikuara të trajnimit, stafi kyç që merr pjesë nga ministritë përkatëse, verifikim i synimeve të të nxënit) - RP 5: Cilësia e raporteve të monitorimit për progresin e ndërtimit të TAP - RP 5: Përshkrim i proceseve ndërinstitucionale me TKP-në përkatëse të përcaktuara - RP 6: Prania publike e AIDA-s, ERE dhe institucioneve të tjera kyçe të përfshira në gazifikim - RP 6: Numri dhe cilësia e materialeve të komunikimit të shpërndara në qeveri dhe jashtë saj në publik mbi TAP-in dhe gazifikimin e Shqipërisë	**Kapacitetet menaxheriale** - RP 5: Monitorohen planet e punës me aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve në ministri - RP 5: Parashikohen mekanizma të rregullta raportimi gjatë projektit të ngritjes së kapaciteteve (p.sh. raporte mujore, raporte tremujore etj.) - RP 6: Komunikimi i projektit TAP përmes faqes së internetit të kompanisë dhe deklaratave për shtyp. - RP 6: Komunikime zyrtare të Qeverisë së Shqipërisë (MEI, institucionet qeveritare dhe agjencitë publike, si dhe ekspertë të sektorit të gazit dhe atij energjetik)	

Strategjia e ndërhyrjes	**Treguesit kyçë të performancës**	**Mënyrat e verifikimit**	**Faktorë të jashtëm (presupozimet/rreziqet**
Rezultatet	**Treguesit e Rezultateve**		
Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit - RP 1: Prezantimi i teknikave për hartim strategjie në sektorë të ndryshëm ekonomikë - RP 2: Këshillim ligjor - RP 2: Hartim dhe zbatim i hartave të proceseve dhe grafikëve në lidhje me procesin e lejeve dhe licencimit - RP 3: Hartim i procedurave standarde të operimit që mund të ndiqen nga projektet në përmasa të mëdha të infrastrukturës së gazit - RP 3: Sigurimi i ekspertizës për përgatitjen e pjesës së tretë dhe të katërt të paketës teknike të rregullave për sektorin e gazit në Shqipëri - RP 3: Është arritur "Testimi i Tregut" të TAP për përcaktimin e kapaciteteve të subjekteve shqiptare për rezervimin e gazit pranë TAP dhe zbatimin e kontratave të blerjes së gazit - RP 4: Dhënie ekspertize mbi standardet ndërkombëtare për organizimin ligjor, strukturën organizative, përgjegjësitë operative dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për agjencinë rregullatore, OST, OSSH, hartimin e politikave dhe agjencinë e promovimit të	**Kapacitete teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit** - RP 1: Modele për Vlerësimin e Ndikimit Ekonomik, planin e sektorit të gazit dhe vlerësimin e propozimeve për projekte, planeve të biznesit etj. - RP 2: Standarde të përshtatura për kuadrin ligjor dhe kontratat bazë - RP 3: Modele për plane biznesi, organigrama dhe plane të tjera për krijimin e SPV-ve - RP 3: Ka përfunduar paketa e tretë dhe e katërt e rregullores teknike për sektorin e gazit në Shqipëri - RP 3: Janë përcaktuar kapacitetet për rezervimin e gazit - RP 4: Organigrama për krijimin e strukturës organizative të institucioneve të ndryshme të përfshira, ku përfshihet instituti i naftës dhe i gazit sapo të jetë vendosur krijimi i tij.		- Rrezik i një ndikimi potencialisht të kufizuar mbi stafin e Task Forcës dhe si rrjedhojë mbi grupin e parë të ngritjes së kapaciteteve - Ndryshim i shpeshtë i zyrtarëve qeveritarë të përfshirë në proces

investimeve si dhe mbështetjen teknike për krijimin e institutit të naftës dhe i gazit			

Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyçë të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorë të jashtëm (presupozimet/rreziqet
Rezultatet	**Treguesit e rezultateve**		
Kapacitetet menaxheriale - RP 5: Hartim dhe bashkërendim i proceseve kyçe për institucionet e lartpërmendura - RP 5: Ofrim ekspertize dhe udhëzimi për menaxhimin e proceseve ndër ministrore, përfshirë instrumentet e vazhdimësisë për ndjekjen e veprimtarive dhe planeve më komplekse të veprimit - RP 5: Mbështetje në përcaktimin e synimeve "S.M.A.R.T" si pikësynime përfundimtare dhe afat mesme brenda plan veprimeve, si dhe për sa i përket krijimit të rutinës së raportimit dhe monitorimit - RP 6: Organizimi i tryezave të punës për trajnim që zhvillojnë kapacitetet për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm me rritjen e aftësive dhe njohurive, si dhe krijimi nga ana strukturore i mesazheve kyçe dhe sjelljeve - RP 6: Përcaktim i mjeteve të komunikimit, krijim i hartës	**Kapacitetet menaxheriale** - RP 5: Mjete dhe instrumente për hartimin e proceseve - RP 5: Modele të përgjithshme për raportimin e rregullt mbi ecurinë e projektit - RP 5: Modele monitorimi për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit - RP 5: Ushtrime trajnimi për veprimtaritë e menaxhimit të projektit (p.sh. detyrat e strukturimit, veprimtaritë e bashkërendimit dhe dhënies përparësi) - RP 6: Materiale komunikimi bazë për fushata të brendshme dhe të jashtme promovimi - RP 6: Mjete komunikimi, mjete për evidentimin e palëve të interesit dhe plane bazë për angazhimin	**Kapacitetet menaxheriale** - RP 5: Mekanizma të raportimit të rregullt të parashikuar gjatë projektit të ngritjes së kapaciteteve (p.sh., raporte mujore, raporte tremujore etj.) - RP 5: Shqyrtime performance nga eprorët e anëtarëve të Task Forcës - RP 5: Shqyrtime të ndërmjetme të mësimeve kryesore deri tani nga anëtarët e Task Forcës	

së palëve të interesit dhe i anketimeve, asistencë në organizim dhe zbatim veprimtarish për dialog me palët e interesit. Ofrim i trajnimeve të GTE-së, nxitje e ekspertizës së GTE-së për prezantimet e zbatimit të TAP-it dhe zhvillimin e tregut të gazit në tryeza pune dhe konferenca			

ANEKSI 3
BUXHETI

Procedura e punës	Kontributi	Shuma
Aftësi teknike të lidhura me infrastrukturën e gazit		
1. Strategjia dhe politika e sektorit.	euro	815,000
2. Legjislacioni, lejet, si dhe kuadri ligjor dhe rregullues i favorshëm për zhvillimin e sektorit të gazit në përputhje me direktivat e BE-së. (*maksimumi 150,000 euro të buxhetit të procedurës së punës 2 janë caktuar për miratimin dhe përkthimin e rregullave të DVGW-së në ligjin shqiptar).	euro	1,100,000*
3. Përfshirja gjatë zhvillimit të Projektit (**maksimumi 300,000 euro të buxhetit të procedurës së punës 3 janë caktuar për financimin e studimit të fizibilitetit për të lidhur Termocentralin e Vlorës me pikën e daljes së TAP-it në Fier. Megjithatë, financimi mund të ndryshojë në varësi të rezultateve të raportit fillestar dhe burimeve alternative të financimit).	euro	1,230,000**
4. Ngritja institucionale, përfshirë mbështetjen për krijimin e institutit të naftës dhe gazit.	euro	1,165,000
kapacitetet menaxheriale		
5. Koordinim/zbatim, përfshirë trajnimet, tryezat e punës, konferencat	euro	1,223,000
6. Komunikim/përfaqësim/publikime	euro	467,000
Shuma e procedurave të punës	euro	**6,000,000**
Mbështetësit, auditimet financiare Studimi (opsional) i fazës mbyllëse të Projektit Studimi (opsional) i vlerësimit pas mbylljes	euro	600,000
Buxheti tërësor i Projektit	**euro**	**6,600,000**

Shënim. Ndarja midis procedurave të punës është vetëm ilustruese dhe mund të ndryshojë gjatë zbatimit të Projektit.

Faza*	Detyrat përgatitore/Arritjet	Pasoja e mospërmbushjes së arritjes

Detyrat përgatitore do të mbyllen deri në fillimin e Projektit (TO)	• Task Forca krijohet nga Qeveria Shqiptare: kjo përfshin emërimin e Anëtarëve të Komisionit Ndërinstitucional, si dhe anëtarët e GTE-së. Në lidhje me caktimin e anëtarëve të rinj të GTE-së do të merret mendimi i SECO-s. • Do të krijohet Njësia e Koordinimit të Projektit pranë MEI-t. Në lidhje me caktimin e anëtarëve të NJKP-së do të merret mendimi i SECO-s. • Siç është shprehur në vendimin e ndryshuar të Këshillit të Ministrave nr. 1081, dhe urdhrit të ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 158, anëtarët e GTE-së janë caktuar të punojnë në ambientet e zyrave në MEI deri 3 ditë në javë me kohë të plotë në përputhje me planet vjetore të punës të miratuara nga komiteti drejtues. Është krijuar hapësirë zyre e përshtatshme për GTE-në, përfshirë linja telefonike dhe interneti.	• Përbërja e Task Forcës, përfshirë caktimin e të dy ekipeve, Komisionin Ndërinstitucional dhe Grupin Teknik të Ekspertëve, si dhe caktimi i Njësisë së Koordinimit të Projektit pranë MEI-t janë kushtëzuese për fillimin e projektit
Arritjet I do të përmbyllen në TO+ 6 muaj	• Janë përfunduar me sukses Marrëveshja Referuese dhe MQVP-ja, Marrëveshja e Përfitimeve Vendore; TAP-it i është dhënë e drejta për tokën e projektit për të nisur ndërtimin. Ka përfunduar me sukses Marrëveshja për Zhvillimin e Tregut të Gazit. • Është siguruar financimi i Studimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit. • Termat e Referencës së Studimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit janë vendosur dhe është caktuar eksperti për studimin.	• Vonesa në përmbylljen e Marrëveshjes Referuese dhe HGA, nëse i atribuohen/vijnë nga qeveria shqiptare, mund të sjellin zvogëlimin e mbështetjes për paketën për ngritjen e kapaciteteve të procedurës përkatëse të punës. • Nëse nuk sigurohet financimi i Studimit të Zhvillimit të Tregut të Gazit, mbështetja në procedurën përkatëse të punës do të ndërpritet.
Arritjet II do të përmbyllen në TO+ 15 muaj	• Janë përfunduar dhe kanë hyrë në fuqi rregullat dhe procedurat për procesin e servitutit të tokës, proceset e ndërtimit dhe monitorimit të qeverisë janë përcaktuar dhe janë në funksionim. • Është marrë dhe vlerësuar Studimi i Zhvillimit të Tregut të Gazit, janë siguruar fondet për Masterplanin e Infrastrukturës së Gazit. Është porositur Masterplani për Infrastrukturën e Gazit.	• Nëse nuk përfundohen rregullat dhe procedurat për procesin e servitutit të tokës dhe nëse ato nuk vihen në veprim, ose nëse proceset e ndërtimit nuk kanë nisur, mbështetja në paketat e procedurave përkatëse të punës do të ndërpritet deri kur ministria drejtuese të paraqesë një plan të plotë pune për zgjidhjen e çështjeve që kanë shkaktuar vonesën. • Nëse nuk mundësohet Studimi i Zhvillimit të Tregut të Gazit, mbështetja për zhvillimin e tregut të gazit ndërpritet deri kur të jetë paraqitur studimi. Nëse nuk sigurohet financimi i Masterplanit të Infrastrukturës së Gazit, mbështetja për paketën përkatëse të procedurave të punës "Përfshirja gjatë zhvillimit të projektit" ndërpritet deri kur të jetë konfirmuar financimi.
Arritjet III do të përmbyllen në TO+ 27 muaj	• Është përfunduar studimi paraprak i fizibilitetit për infrastrukturën e rrjedhës së poshtme në Shqipëri (p.sh. tubacionet e transmetimit, stacionet e kompresimit dhe matjes, dhe projektet e testimit të ngarkesës), është vendosur struktura tarifore për infrastrukturën në rrjedhën e poshtme. • Është hartuar lista e infrastrukturës në rrjedhën e poshtme (veçanërisht projektet e testimit të ngarkesës), përfshirë skemat e financimit strategjik dhe investitorët e mundshëm (për të përmbushur kërkesën fillestare të Shqipërisë për gaz për të paktën 0.3 bcm). • Janë përmbyllur marrëveshjet e shitjes së gazit me furnitorët e TAP-it për të siguruar furnizimin me gaz përmes TAP-it për jo më pak se 0.3 bcm në vit.	• Nëse studimi i para fizibilitetit për infrastrukturën kritike në rrjedhën e poshtme vonohet në mënyrë thelbësore, mbështetja për identifikimin e infrastrukturës përkatëse në rrjedhën e poshtme dhe për përgatitjen e termave të referencës për studimin e para fizibilitetit do të vijojnë, por mbështetja për ngritjen e kapaciteteve për paketa të tjera të procedurës së punës për zhvillimin e tregut të gazit do të ndërpriten. • Nëse negociatat për marrëveshjet e shitjes me furnitorët e TAP-it janë të pezulluara, - nëse ky pezullim i atribuohet qeverisë shqiptare - mbështetja për zhvillimin e tregut të gazit ndërpritet deri kur të rinisin negociatat.
Vjetore	• MEI harton plane vjetore për GTE-në dhe për punonjësit kyç në ministritë përkatëse • Planet e punës miratohen nga këshilli drejtues • MEI monitoron zbatimin e planeve të punës • Është përgatitur programi i trajnimit për GTE-në, si dhe institucionet qeveritare, agjencitë publike, entet dhe sektorin e gazit	• Nëse planet e punës nuk janë përmbushur, vonohen shumë ose nëse nuk monitorohen, atëherë mbështetja mund të ndërpritet në paketat e prekura të rrjedhës së punës.

ANEKSI 4
ARRITJET (*ARRITJET DO TË PËRMBYLLEN NGA QEVERIA SHQIPTARE; MBËSHTETJA PËR ARRITJET I-III DO TË OFROHET NGA KONSULENTI)

ANEKSI 5
VENDIMI I NDRYSHUAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1081 I DATËS 18.12.2013

Për krijimin e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)

Në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr. 116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik AG në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)", të ligjit nr. 104/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)" dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9946, të datës 30.6.2008, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), i emërtuar "Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP".

2. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP kryesohet nga ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- zëvendësministrin e Energjisë dhe Industrisë;
- zëvendësministrin e Punëve të Brendshme;
- zëvendësministrin e Financave;
- zëvendësministrin e Drejtësisë;
- zëvendësministrin e Mjedisit;
- zëvendësministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- zëvendësministrin e Transportit dhe Infra-strukturës;
- zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- zëvendësministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- drejtorin e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;
- zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Doga-nave;
- zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tati-meve;
- zëvendëskryeregjistruesin e Zyrës së Re-gjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) Bashkërendimin e punës në zbatimin e detyrimeve kontraktuale të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik AG në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP), të ratifikuara nga Parlamenti;

b) Bashkërendimin ndërministror të punës për formulimin e qëndrimeve që do t'i paraqiten për trajtim dhe/ose vendimmarrje Këshillit të Ministrave dhe, sipas rastit, Parlamentit në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP), të ratifikuara nga Parlamenti;

c) Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me institucionet e pavarura dhe/ose entet rregullatore të Republikës së Shqipërisë që kanë detyra ose janë përgjegjëse për zbatimin e detyrave në realizimin e Projektit TAP, në kuadër të marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;

ç) Përcaktimin e detyrave për institucionet dhe subjektet e varësisë të ministrive dhe kontrollin e zbatimit të tyre.

4. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP mblidhet çdo 3 (tre) muaj ose në çdo kohë, me kërkesë të kryetarit.

5. Në mbledhjet e Komisionit Ndër-institucional për Projektin TAP mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore dhe të institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të bashkërendimit të punës në zbatimin e Projektit TAP.

6. Kryetari i Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP i raporton Kryeministrit për ecurinë e realizimit të Projektit TAP, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të arritura, si dhe për çështje të veçanta.

7. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili ka këto detyra kryesore:

- përgatitjen e takimeve të këtij Komisioni;
- raportimin periodik në mbledhjet e këtij Komisioni mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme ose që janë në zbatim të marrëveshjeve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;
- bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për zbatimin e detyrave të këtij Komisioni, si dhe monitorimin e zbatimit të këtyre detyrave;
- bashkërendimin e punës me shoqërinë TAP AG për aspektet e ndryshme të plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë që lindin nga marrëveshjet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;
- mbështetjen e shoqërisë TAP AG në proceset dhe marrëdhëniet me institucionet që janë të

përfaqësuara në këtë Komision;

- kryerjen e detyrave të tjera që përcaktohen nga kryetari i këtij Komisioni.

8. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

Për përcaktimin e nëpunësve të mjaftueshëm civilë dhe ditëve të tyre të punës të nevojshëm në GTE, ministrat ose drejtorët e agjencive që dërgojnë anëtarë në GTE do të ofrojnë të gjithë mbështetjen e nevojshme që do të nevojitet për zbatimin e Projektit dhe do të alokojnë burimet e duhura për nëpunësit e tyre civilë për të ndërvepruar me Konsulentin, kontraktuesit e tjerë dhe çdo palë tjetër interesi e Projektit. Ditët e punës në GTE llogariten deri në 3 ditë të plota pune në javë dhe mund të ndryshojnë në varësi të detyrave operacionale që duhet të realizohen nga Projekti sipas planeve vjetore të punës të miratuara nga komiteti drejtues.

9. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe institucionet e përfaqësuara në Komisionin Ndërinstitucional për Projektin TAP ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Urdhër i ministrit të Industrisë dhe Energjisë nr. 158, datë 3.4.2014

Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e Sekretariatit Teknik në kuadër të Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e Projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)

Në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 27.1 të "Marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik AG në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)", të ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, si dhe pikës 8, të vendimit nr. 1081, të datës 18.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Sekretariatit Teknik në kuadër të "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP", me përbërje.

- z. Dritan Spahiu	DPZHH, MEI, Koordinator i Sekretariatit Teknik
- z. Arian Hoxha	Këshilltar i ministrit, MEI
- znj. Aurora Alimadhi	DJ, MEI
- z. Stavri Dhima	DPZHH, MEI
- znj. Emiriana Xhaferri	DPZHH, MEI
- znj. Fiona Minga	DPZHH, MEI
- z. Bekim Murati	MPB
- znj. Giomela Gjini	MF
- z. Gjergji Butka	MF
- z. Gojart Laçi	MD
- z. Nihat Dragoti	MM
- z. Ilir Qerfozi	MZHUT
- z. Marenglen Poreci	MTI
- znj. Klotilda Neziri	MZHETS
- z. Albin Gega	MZHETS
- z. Shaqir Xhumari	MBZHRAU
- z. Reshit Uruçi	MBZHRAU

2. Koordinator administrativ i Sekretariatit Teknik në kuadër të "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP" do të jetë Sektori i Politikave dhe Zhvillimit të Gazit në MEI.

Anëtarët e Sekretariatit Teknik, që përfaqësojnë ministrinë përkatëse, janë edhe pika kontakti për problemet dhe çështjet që trajtohen nga ajo ministri apo struktura dhe institucione të vartësisë së saj.

3. Sekretariati Teknik, përveç detyrave të përcaktuara në pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1081, të datës 18.12.2013, do të realizojë edhe këto detyra specifike:

- Kryen vlerësime në nivel të ekspertizës profesionale teknike dhe/ose ekonomike në lidhje me çështje

dhe probleme që lindin nga zbatimi i marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 18.12.2013 dhe sipas rastit informon kryetarin e "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP" ose në mbledhjen e radhës të këtij Komisioni.

- Me kërkesë të përfaqësuesve të Shoqërisë TAP AG ose të strukturave të pushtetit vendor apo edhe të një institucioni të veçantë, si dhe në raste të veçanta me iniciativë të tij, ndjek dhe vlerëson në terren probleme që lidhen me realizimin e punimeve të ndërtimit për Projektin TAP, duke bashkërenduar punën edhe me organet e pushtetit vendor në zonën ku ka lindur problemi. Për këto çështje informon pranë kryetarit të "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP" ose në mbledhjen e radhës të këtij Komisioni.

- Mban procesverbalin dhe minutat e takimeve të "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP".

4. Mbledhjet e Sekretariatit Teknik thirren dhe drejtohen nga zëvendësministri i Energjisë dhe Industrisë, me qëllim përgatitjen e takimeve të punës të "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP", si dhe për të trajtuar çdo problem të paraqitur nga Shoqëria TAP AG dhe që lidhet me plotësimin e detyrimeve që lindin nga marrëveshjet e përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1081, të datës 18.12.2013.

Sekretariati Teknik mblidhet jo më rrallë se një herë në tre muaj ose në çdo kohë, me kërkesë të zëvendësministrit të Energjisë dhe Industrisë.

Në varësi të problematikës që do të trajtojë "Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP", mbledhjet e Sekretariatit Teknik si rregull zhvillohen jo më pak se dy ditë para mbledhjes së këtij Komisioni.

Në njoftimin që u dërgohet anëtarëve të Sekretariatit Teknik përcaktohet rendi i ditës i mbledhjes, ora dhe vendi i mbledhjes, si dhe vihen në dispozicion materialet për çështjet që do të diskutohen në mbledhje.

5. Në vartësi të problematikës që do të trajtojë Sekretariati Teknik, në mbledhjet e tij mund të thirren për të marrë pjesë edhe përfaqësues dhe ekspertë të Shoqërisë TAP AG, si dhe përfaqësues dhe ekspertë nga struktura dhe institucione në përbërje dhe varësi të ministrive që bëjnë pjesë në "Komisionin Ndërinstitucional për Projektin TAP".

6. Sekretariati Teknik, në përfundim të çdo mbledhjeje përgatit informacionin dhe propozimet përkatëse për "Komisionin Ndërinstitucional për Projektin TAP" për secilën nga çështjet e rendit të ditës për të cilat kërkohet të vihet në dijeni ose duhet të merret vendim nga "Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP".

Informacionet dhe materialet problemore që i paraqiten "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP" në emër të Sekretariatit Teknik, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, si dhe nga zëvendësministri i Energjisë dhe Industrisë, që drejton mbledhjen.

7. Sekretariati Teknik, në javën e tretë të muajit dhjetor të çdo viti kalendarik, përgatit për "Komisionin Ndërinstitucional për Projektin TAP" një informacion përmbledhës për ecurinë e realizimit të Projektit TAP gjatë atij viti. Ky informacion pas shqyrtimit nga ana e "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP" i paraqitet Kryeministrit.

8. Materialet dhe dokumentacioni që shfrytëzon dhe/ose përgatit Sekretariati Teknik, si dhe materialet e punës dhe praktikat shkresore të "Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP" trajtohen nëpërmjet Zyrës së Arkiv-Protokollit të MEI-t.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Damian Gjiknuri

ANEKSI 6
UDHËZIMET MBI PROKURIMET TË SECO-s



UDHËZIME
PËR DHËNIEN E KONTRATAVE NË KUADËR TË FINANCIMIT TË INFRASTRUKTURËS NGA SECO-ja NË VENDET NË TRANZICION DHE NË ZHVILLIM

Përmbledhje e bashkëpunimit të Zvicrës për zhvillim ekonomik

- Departamenti i Zhvillimit dhe Tranzicionit të Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) është përgjegjës në lidhje me masat ekonomike dhe tregtare të Zvicrës në dobi të vendeve në tranzicion në Evropën Lindore dhe ish-Bashkimin Sovjetik, si dhe për vendet në zhvillim. Qëllimi është ulja e varfërisë nëpërmjet promovimit të rritjes së qëndrueshme dhe përmirësimit të standardit të jetesës.

- Pesë linjat më të rëndësishme të veprimit në bashkëpunimin e zhvillimit ekonomik janë si më poshtë:

- Kuadri ekonomik: Përmirësimi i kushteve të përgjithshme makroekonomike për nxitjen e rritjes dhe investimeve;

- Investimet: Shfrytëzimi i kapitalit, njohurive dhe teknologjive nga sektori privat;

- Tregtia: Promovimi i tregtisë dhe integrimi i vendeve në zhvillim në tregtinë botërore;

- Infrastruktura: Përmirësimi i infrastrukturës ekonomike dhe shoqërore;

- Institucionet multilaterale të financimit: Forcimi i bashkëpunimit multilateral dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Financimi në infrastrukturë mbështet vendet partnere për krijimin e infrastrukturave të tyre ekonomike dhe shoqërore kryesore. Ato shërbejnë për të financuar mallrat dhe shërbimet e kapitalit, kryesisht nga Zvicra, të cilat shërbejnë për të krijuar ose përmirësuar objektet e infrastrukturës. Gjithashtu, kjo mbështetje shërben për të përmirësuar kushtet e përgjithshme në sektorin dhe menaxhimin e kompanive të shërbimeve. Kur është e mundur, bëhen përpjekje për të inkurajuar firmat private që të marrin pjesë në partneritetin publik-privat.

- Fokusi kryesor është për projektet në fushën e ujit, mjedisit, energjisë dhe regjistrimit të tokës. Theks i veçantë është dhënë për parandalimin dhe eliminimin e dëmit mjedisor. Instrumentet e financimit të përdorura janë ndihma të parimbursueshme financiare dhe kredi të kombinuara (një kombinim i subvencioneve të qeverisë federale dhe kredive tregtare nga bankat zvicerane). Volumi i projekteve për financimin e infrastrukturës arrin rreth 70 milionë CHF në vit. Tenderët paraqiten në Fletoren Tregtare Zyrtare Zvicerane, www.shab.ch dhe, gjithashtu, mund të gjenden në faqen e internetit të SECO-s, www.seco.admin.ch.

I. Hyrje **Qëllimi** - Këto udhëzime synojnë të rregullojnë tenderimin dhe dhënien e kontratave për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve dhe për punë ndërtimore në kuadër të projekteve të Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) për financimin e infrastrukturës në vendet në tranzicion dhe zhvillim. - Udhëzimet sigurojnë të dhëna mbi kërkesat e përcaktuara nga SECO-ja për caktimin e procedurës dhe mallrave të përftuara, shërbimeve dhe kontratave të ndërtimit. Këta udhëzues janë pjesë e sistemit të certifikuar të cilësisë ISO-9001 të Departamentit të Zhvillimit dhe Tranzicionit të SECO-s.	**Zbatimi** - Në plan të parë qëndrojnë ndihma të kushtëzuara të parimbursueshme financiare në vendet në tranzicion; megjithatë udhëzimet mund të zbatohen gjithashtu për tenderët e mbikëqyrura nga SECO-ja në kuadër të projekteve të kombinuara të financimit në vendet në zhvillim. - Në projektet bashkëfinancuese mund të zbatohen gjithashtu dispozitat e institucionit korrespondues ndërkombëtar financiar. - Tenderët nga SECO-ja për shërbimet e këshillimit për përgatitjen dhe vlerësimin e projekteve të tij nuk mbulohen nga këto udhëzime.	**II. Procedura e prokurimit** **1. Roli i porositësit dhe SECO-s** **Roli i porositësit** - Në kuadër të financimit të infrastrukturës, SECO-ja financon furnizimin e komponentëve kryesisht zviceranë, për ndërtimin, rehabilitimin dhe modernizimin e objekteve të infrastrukturës në vendet në tranzicion dhe zhvillim. Sponsor i procedurës së prokurimit dhe partner kontraktues është porositës i huaj. SECO vepron si institucion financues. **Detyrimet e SECO-s** - SECO-ja është e detyruar të sigurojë që burimet publike të shfrytëzuara në kuadrin e financimit të infrastrukturës të	Gjithashtu, SECO-ja shqyrton nëse draft kontratat që do të paraqiten në kuadër të përcaktimit të procedurës marrin parasysh siç duhet praktikat tregtare ndërkombëtarisht të zbatueshme për degën korresponduese, veçanërisht në lidhje me përgjegjësinë, kushtet e shlyerjes dhe garancitë, dhe nëse draftet nuk kanë të meta apo mospërputhje të cilat mund të cenojnë zbatimin e projektit. **Konsulenti shoqërues** - Porositësi i huaj (në përgjithësi në bashkëpunim me SECO-n) do të angazhojë një konsulent të pavarur të kualifikuar zviceran për realizimin e përcaktimit të procedurës, detyrat e

		përdoren në mënyrë sa më ekonomike që të jetë e mundur. Rrjedhimisht ai duhet të garantojë se procedura e tenderit për dhënien e kontratave për mallrat dhe shërbimet është e drejtë dhe transparente dhe se tenderi konkurrues ofron mundësi të barabarta për të gjithë furnizuesit, i cili siguron përcaktimin e ofertave ekonomikisht më të përshtatshme dhe për këtë arsye përdorimin më efektiv të burimeve të pakta.	së cilës do të përfshijnë përgatitjen e dokumentacionit të tenderit për kontratat e furnizimit, shërbimeve dhe ndërtimit në bashkëpunim me porositësin, vlerësimin e tenderit, këshillimin e porositësit në vlerësimin e kontratës dhe sigurimin e mbështetjes në hartimin e kontratës, në negociatat dhe zbatimin e kontratës.

2. Procedurat e tenderimit

Parimi bazë
- Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve dhe kryerja e punimeve ndërtimore për projektet e financuara nga fondet e financimit të infrastrukturës duhet që në parim të paraqiten në tender të hapur nga porositësi, pra nëpërmjet një procedure të hapur ose përzgjedhëse. Kjo bëhet me qëllim që të sigurohet mjedisi më i mundshëm konkurrues.

Procedura e hapur dhe përzgjedhëse
- Në një procedurë të hapur, të gjithë ofertuesit e interesuar mund të paraqesin një tender.

- Procedura përzgjedhëse ndryshon nga procedura e hapur në faktin që të gjithë furnizuesit mund të paraqesin një kërkesë për të marrë pjesë në një procedurë të hapur paraprake kualifikimi, por vetëm ato që plotësojnë kriteret e kualifikimit do të ftohen për të paraqitur tenderin. Një procedurë paraprake kualifikimi e këtij lloji përdoret kryesisht për projektet në përmasa të mëdha ose teknikisht komplekse. Synohet të sigurohet që vetëm firmat e përshtatshme që janë të afta për shpërndarjen në kohë të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme, të marrin pjesë në procedurën e tenderit.

4. Procesi i tenderimit
4.1 Dokumentacioni dhe shpallja e tenderit

Dokumentacioni i tenderit
- Dokumentacioni i tenderit duhet

Procedura ftesë dhe e vetme e tenderimit
- Përjashtimet e parimit të tenderit të hapur mund të bëhen në formën e procedurës ftesë dhe të vetme të tenderimit.

- Procedura ftesë e tenderimit është e lejueshme për prokurimet nën nivelin e pragut, aktualisht 248,950 CHF për mallrat dhe shërbimet dhe 9.575 milionë CHF për projektet e ndërtimit.
Porositësi duhet të ftojë minimalisht tre furnizues për paraqitjen e tenderit.
- Procedura e vetme e tenderimit është e lejueshme për prokurimet që nuk tejkalojnë nivelin e pragut prej 50,000 CHF për kontratat e mallrave dhe shërbimeve dhe 100,000 CHF për kontratat e ndërtimit, si dhe për arsye ekonomike ose teknike të lidhura me projekte specifike.
- Objektivi kryesor i këtyre caktimeve mbetet përcaktimi i ofertës ekonomikisht më të përshtatshme.
Baza ligjore
- Meqë kjo procedurë lidhet me tenderët nga një drejtues i huaj në kuadrin e një marrëveshjeje qeveritare, këta tenderë nuk janë pjesë e Ligjit Federal për Prokurimet Publike (LPP) dhe e Urdhëresës korresponduese për Prokurimet Publike (UPP). Megjithatë, këto udhëzime bazohen në marrëveshjen përkatëse të OBT-së, LPP-së dhe UPP-së.
- Kushtet e tenderit duhet të përcaktojnë qartë dhe pa mëdyshje detyrimet që duhet të miratohen më vonë nga partneri kontraktues. Kjo zbatohet veçanërisht për qëllimin e furnizimit dhe vendin e shpërndarjes, përgjegjësinë dhe detyrimet e garancisë, si dhe për taksat dhe detyrimet publike që duhet të mbulohen nga tenderuesi.

3. Kapaciteti i Zvicrës

Huaja e kushtëzuar
- Të dyja grantet financiare për vendet në tranzicion dhe kreditë e kombinuara për vendet në zhvillim përbëjnë ndihmë të huaj të kushtëzuar. Procesi i tenderimit për këtë arsye kufizohet për kompanitë që janë shënuar në regjistrin tregtar në Zvicër.

Kapaciteti i Zvicrës
- Gjithashtu, normalisht të paktën 50% e vlerës së shtuar të furnizimeve duhet të vijë nga Zvicra. Parimi në vijim zbatohet për llogaritjen e proporcionit të vlerës së shtuar të Zvicrës:

- Vlera e shtuar zvicerane llogaritet nga diferenca ndërmjet çmimit të tenderuar të shitjes dhe çmimit të lëndëve të para, komponentëve dhe/ose shërbimeve të tjera të marra nga jashtë.
- Vlera e shtuar zvicerane në thelb lidhet me paketën e furnizimit të tenderuar si e tërë (dhe rrjedhimisht jo me çdo nënkomponent individual).

Shqyrtimi nga SECO-ja

- Dokumentet e tenderit duhet t'i paraqiten SECO-s për miratim (pa kundërshtim) në kohën e duhur para

- Faktori përkatës në përcaktimin e vlerës së shtuar zvicerane përfshin dispozitat e Agjencisë Zvicerane të Garantimit ndaj Riskut të Eksportit (GRE) në lidhje me llogaritjet e vlerës së shtuar zvicerane në caktimin e garancive ndaj riskut të eksportit. E drejta rezervohet për të verifikuar kapacitetin e vlerës së shtuar zvicerane nga tenderuesit.

- Kapaciteti i nevojshëm minimal i vlerës së shtuar zvicerane mund të ulet nëse mungon konkurrenca e duhur për një tender. Për të garantuar karakterin zviceran të projektit, në këtë rast duhet të garantohet se menaxhimi bëhet në Zvicër. Dokumentacioni i tenderimit siguron detaje për kapacitetin e nevojshëm minimal të vlerës së shtuar zvicerane.

Marrja në konsideratë
- Kapaciteti i vlerës së shtuar zvicerane është para së gjithash kriter kualifikimi dhe jo kriter për vlerësimin e çmimit; megjithatë në rastin e ofertave të njëjta ky kriter mund të bëhet kriter për vlerësimin e çmimit.

4.2 Hapja e tenderëve, vlerësimi dhe refuzimi i hapjes së tenderëve

- Me qëllim që të sigurohet transparenca më e madhe e

të njohë tenderuesit e mundshëm me mallrat dhe shërbimet dhe punët ndërtimore që parashikohen të ofrojnë përkatësisht për të kryer në kushte të caktuara brenda afatit të përcaktuar. Ato duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të garantohet e drejta me mundësi të barabarta për të gjithë tenderuesit. Megjithëse objekti dhe paraqitja e dokumentacionit varen nga projekti individual, gjithsesi duhet të përmbajnë rregullisht: - Kushtet e tenderimit (afatin e paraqitjes, vendin e paraqitjes, dokumentacionin e nevojshëm, procedurën e mëtejshme për vlerësimin e çmimit, hapjen e procedurës së tenderit etj.); - Kriteret e kualifikimit (për pranim/eliminim); - Kriteret për vlerësimin e çmimit (sipas rendit të rëndësisë së informacionit për vlerën e tyre, përshkrimin e procedurës së vlerësimit etj.); - Përshkrimin e projektit dhe dokumentet e planifikimit; - Përshkrimin e produktit ose detyrës ose një katalog të detajuar shërbimesh në lidhje me kapacitetin e nevojshëm minimal të vlerës së shtuar zvicerane; - Kushtet e kontratës; - Nëse është e nevojshme, një shembull i shlyerjes paraprake dhe garancive të performancës.	**Afati** - Afati i paraqitjes në përgjithësi nuk duhet të jetë më pak se 40 ditë, megjithëse në raste të veçanta ky afat mund të ulet. Shtyrja e afatit të paraqitjes, që duhet të lejohet vetëm në rrethana të veçanta duhet t'i bëhet i njohur të gjithë tenderuesve me shkrim në kohë para skadimit të afatit fillestar. Pyetjet nga ana e tenderuesve në lidhje me dokumentacionin e tenderit mund të marrin përgjigje deri në kohën e deklaruar në dokumentacion; pyetjet dhe përgjigjet do të jenë të disponueshme për të gjithë tenderuesit.	shpalljes. SECO-ja kontrollon nëse janë përmbushur dispozitat e udhëzuesve aktualë. Vëmendje e veçantë i kushtohet garantimit që periudha e paraqitjes është aq e gjatë sa t'i mundësojë tenderuesve kohën e duhur për të përgatitur tenderin e tyre, duke marrë parasysh qëllimin dhe kompleksitetin e projektit. Konsulenti është përgjegjës për integritetin teknik të dokumentacionit të tenderit. **Njoftimi** - Njoftimi bëhet në Fletoren Tregtare Zyrtare Zvicerane (SOCG/SHAB) dhe, gjithashtu, publikohet në faqen e internetit të Departamentit të Zhvillimit dhe Tranzicionit të SECO-s. Njoftimi bëhet në përputhje me direktivat e përcaktuara në LPP dhe UPP nën titullin "Procedurat e tenderit që nuk janë pjesë e Marrëveshjes së OBT-së".	mundshme, hapja e tenderëve për kontrata furnizimi dhe ndërtimi me procedura të hapura dhe përzgjedhëse nga porositësi dhe/ose konsulenti i autorizuar do të bëhet në përgjithësi publikisht në kohën dhe vendin e përcaktuar në dokumentacionin e tenderit. Të gjitha palët që kanë paraqitur një ofertë kanë të drejtë të ndjekin hapjen. Hapja e tenderëve për kontrata shërbimesh mund të bëhet, gjithashtu, privatisht. Në të gjitha rastet duhet të mbahen procesverbale të hapjes së tenderëve. **Vlerësimi dhe refuzimi i ofertave** - Pas hapjes, ofertat duhet të vlerësohen formalisht për të verifikuar nëse janë paraqitur të plota brenda afatit të caktuar për paraqitjen nëse përmbushin kushtet e tenderimit dhe kriteret e kualifikimit.
Oferta eliminohet nga vlerësimi i mëtejshëm kur: - Oferta është marrë pas skadimit të afatit për paraqitjet; nëse tenderuesi në fjalë nuk është përgjegjës për paraqitjen e vonuar të ofertës dhe si rezultat nuk fiton avantazhe ndaj tenderuesve të tjerë; - Oferta përmban kushtëzime ose kufizime të pavend; - Oferta zbulon se tenderuesi nuk përmbush kritere të caktuara kualifikimi (dhe në veçanti kriterin për ndihmën e huaj të kushtëzuar);	**Negociatat** - Negociatat janë të mundshme, me kusht që kjo mundësi të paraqitet në dokumentacionin e tenderit ose në mungesë të një oferte më të përshtatshme ekonomikisht, duhet të merren parasysh parimet e konfidencialitetit, veprimit të dokumentit dhe trajtimit të barabartë. **Ushtrimi i ndikimit** - Gjithashtu, me qëllim që të sigurohet konkurrencë e ndershme në kushte të barabarta në kohën ndërmjet hapjes së tenderave dhe vlerësimit të çmimit, janë të papranueshme kontaktet ndërmjet një tenderuesi dhe porositësit, si dhe ndryshimet e njëanshme të	**4.3 Vlerësimi dhe procedura për vlerësimin e çmimit** - Ofertat e tenderit vlerësohen nga porositësi në bashkëpunim me konsulentin ose nga konsulenti i autorizuar nga porositësi. Qëllimi i vlerësimit krahasues është të përcaktojë ofertën ekonomikisht më të përshtatshme me anë të vlerësimit/mbledhjes së kritereve përkatëse të ofertave individuale dhe krahasimi vijues i ofertave. **Kriteret për vlerësimin e çmimit** - Çmimi i jepet ofertës ekonomikisht më të përshtatshme (që nuk është domosdoshmërisht e njëjtë me ofertën me çmimin më të ulët). Gjithashtu, merren parasysh së bashku me çmimin edhe elemente të tjera të rëndësishme	- Në rastin e kualifikimit paraprak, elementet që janë marrë në konsideratë në këtë procedurë nuk janë më objekt vlerësimi. Kriteret për vlerësimin e çmimit duhet të pasqyrohen në njoftimin e tenderit sipas rendit të rëndësisë, si dhe të dhënat për vlerën e tyre. - Në rastin e një procedure

- Nuk mund të sigurohen prova për përputhjen me dispozitat e shëndetit dhe sigurisë dhe barazisë ndërmjet burrit dhe gruas në lidhje me pagesën e njëjtë. - Mospërputhjet që nuk cenojnë ndjeshëm përmbajtjen materiale të ofertës, të tilla si gabimet e dukshme të shtypit ose llogaritjet e gabuara, në përgjithësi nuk çojnë në eliminim por korrigjohen dhe/ose qartësohen pas konsultimit me tenderuesin.	ofertave. Çdo përpjekje për të ushtruar ndikim ose korrupsioni i bërë nga një tenderues në këtë fazë të procesit mund të çojë në përjashtimin e ofertuesit.	thelbësore për suksesin e projektit. - Kritere të tjera përkatëse për vlerësimin e çmimit (në varësi të objektit të kërkuar të furnizimit për mallra ose shërbime), për shembull, janë: - Përshtatja ose cilësia e ofertës/metodologjia e paraqitur; - Planifikimi/afatet (periudhat e shpërndarjes, koha e ndërtimit etj.); - Kualifikimet e stafit të përfshirë; - Përvoja me projekte të ngjashme dhe njohja e kushteve lokale; - Kostot e operimit; furnizimi me pjesë rezervë; shërbimi i klientit; trajnimi i stafit lokal.	të vetme tenderimi, vlerësimi i përshtatshmërisë së çmimit të ofertës zëvendëson krahasimin e çmimit të disa ofertave. Një gjë e tillë merr kryesisht formën e analizës së kostos, përmes krahasimeve me oferta të ngjashme të tenderuesit dhe duke marrë parasysh elementet e përmendura më lart. Nëse është e nevojshme, tenderuesi duhet të paraqesë provat e kërkuara. **Raporti i vlerësimit** - Rezultati i vlerësimit përmblidhet në një raport që do t'i paraqitet SECO-s. SECO-ja shqyrton këtë vlerësim tenderi dhe vendos (pa kundërshtim) nëse mund të jetë dakord me rekomandimin e çmimit të porositësit ose/dhe të konsulentit.
Revokimi - Një çmim, menjëherë pasi caktohet, mund të revokohet nën kushte të jashtëzakonshme, veçanërisht kur p.sh. janë marrë të dhëna të rreme ose ka ndodhur një përplasje që eliminon ose cenon konkurrencën dhe/ose kriteret e kualifikimit nuk përmbushen më. Për më tepër, në rastet e korrupsionit jo vetëm që çmimi mund të revokohet, por edhe kontrata mund të anulohet dhe kompania në fjalë të përjashtohet nga pjesëmarrja e mëvonshme në tenderë për një periudhë deri në tre vjet. Gjithashtu, mund të vijojnë procedurat ligjore. **Mbyllja e kontratës** - Mbyllja e kontratës ndërmjet porositësit dhe furnizuesit mund të bëhet pas caktimit të çmimit. **5. Ndërprerja, përsëritja, procedura e re** Ndërprerja - Procedura e tenderimit mund të ndërpritet nëse projekti nuk është realizuar. **Ndërprerja dhe përsëritja** - Procedura mund të ndërpritet dhe përsëritet në rast se: - asnjë ofertë nuk përmbush kriteret për vlerësimin e çmimit; - ndërkohë mund të parashikohen	- Mund të parashikohen oferta ekonomikisht më të përshtatshme pasi prishjet e konkurrencës pushojnë së ekzistuari (p.sh. përplasja e çmimeve nga furnizues individualë). **Procedura e re** - Një procedurë e re për vlerësimin e çmimit mund të realizohet nëse kushtet bazë të tenderit ndryshojnë ndjeshëm. Në çdo rast, argumentet për ndërprerje nuk duhej të ishin parashikuar në momentin kur filloi procedura për vlerësimin e çmimit. **6. Mbikëqyrja** **Ankesat** - SECO-ja do të pranojë çdo ankesë në lidhje me procedurën e tenderimit. Ai siguron se ankesat janë shqyrtuar dhe se, nëse është e nevojshme, procedura korrigjohet. SECO-ja rezervon të drejtën për të përjashtuar kontratën nga financimi i mëtejshëm. **E drejta e apelimit** - Meqenëse kjo procedurë lidhet me tenderët e kryer nëpërmjet një porositësi të	**III. Kushtet e kontratës** **1. Parimet bazë** **Pika kryesore e tenderit** - Përveç specifikimeve teknike, kushtet e kontratës përbëjnë aspektin kryesor të dokumentacionit të tenderit. Ato formojnë bazën e kontratës së mëvonshme të furnizimit, shërbimit dhe ndërtimit ndërmjet porositësit dhe kontraktuesit. Ato përcaktojnë, gjithashtu, obligimet detyruese të palëve kontraktuese që janë thelbësore për suksesin e projektit. **Palët kontraktuese** - Kontrata lidhet ndërmjet porositësit të huaj dhe kontraktuesit nën mbikëqyrjen e konsulentit shoqërues. Të gjitha kontratat duhet të përmbajnë një klauzolë ku të deklarohet se financimi i kontratës do të kryhet me ndihmën financiare të Zvicrës në vendin specifik marrës ose përkatësisht linja e kredive të kombinuara ndërmjet Zvicrës dhe vendit marrës. SECO-ja duhet të miratojë të gjitha kontratat para nënshkrimit të tyre.	**Çmimi** - Për kontratat që jepen përmes tenderimit të hapur (d.m.th. me procedurë të hapur ose përzgjedhëse), shpallja e çmimit duhet të publikohet pa vonesë përsëri në Fletoren Tregtare Zyrtare Zvicerane (SOCG/SHAB), nën titullin "Kontratat e Vlerësuara". **Kontrata model** - Në përputhje me praktikën e përgjithshme, porositësi mund të përdorë një kontratë model ndërkombëtare të pranuar në përgjithësi si bazë për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të kontratës ose faktikisht kontratën aktuale. Kjo zbatohet për shembull për "Kushtet e Kontratës për Punimet e Ndërtimit të Inxhinierisë së Ndërtimit", për "Pajisjet dhe planndërtimin" dhe për "Projektet kyçe të EPC/Kthimit" të

oferta ekonomikisht më të përshtatshme për shkak të zhvillimeve teknike. **2. Mangësitë në përgjegjësi** - Kushtet e përgjegjësisë kanë rëndësi kryesore për suksesin e projektit. Për këtë arsye kjo fushë kërkon vëmendje të veçantë. Për projektet që përfshijnë kontraktues të ndryshëm, kushtet e përgjegjësisë duhet të rregullohen në mënyrë të tillë që të mos lindin mangësi në përgjegjësi. Mangësi të tilla mund të ndodhin kur nuk janë harmonizuar siç duhet specifikimet dhe planifikimet për komponentë të ndryshëm. Probleme të tilla të ashtuquajtura probleme të ndërlidhjes mund të rezultojnë në vonesa dhe kosto shtesë, nëpërmjet të cilave është më pas e vështirë për të përcaktuar përgjegjësinë për gabimet pasi nuk ekziston një marrëveshje e veçantë për përgjegjësinë në këto fusha. **Përgjegjësia e qartë e përgjithshme** - Kur është e mundur, veçanërisht në rastin e projekteve komplekse që janë të vështirë për t'u bashkërenduar për arsye teknike ose kohore, duhet të zgjidhet një marrëveshje kontraktuale sipas së cilës një partner kontraktues merr përsipër përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e projektit. Për rrjedhojë, porositësi duhet të hyjë në marrëveshje vetëm me këtë partner kontraktues, pavarësisht faktit se janë përfshirë disa furnizues. Në rastin kur përfshihen konsorciume, duhet të kërkohet lidership i qartë i përgjithshëm dhe përgjegjësia e përbashkët e firmave të përfshira.	huaj në kuadër të një marrëveshjeje ndërqeveritare, këta tenderë nuk hyjnë në objektin e LPP-së dhe UPP-së. Për rrjedhojë, nuk gjejnë zbatim procedurat e apelimit kundër vendimeve të marra nga porositësi, të parashikuara në LPP dhe UPP. **3. Kushtet e pagesës** **Parimet bazë** - Kushtet e pagesës duhet në thelb të përcaktohen në mënyrë të tillë që pagesat të korrespondojnë me dispozitat e mallrave dhe shërbimeve dhe me progresin e projektit. Për këtë arsye duhet të merren parasysh kushtet e zakonshme ndërkombëtare për çdo fushë. Kontratat (ashtu si edhe garancitë dhe pagesat e sigurimeve) duhet të plotësohen në franga zvicerane, nëse është e nevojshme në US $ ose euro. **Kushtet e pagesës për dorëzimin dhe instalimin e mjeteve kapitale** - Një model bazë i kushteve të pagesës për produktet më të zakonshme dhe instalimin e mjeteve kapitale parashikon pagesat në vijim: - Pagesën paraprake prej 20% të vlerës së kontratës në mbyllje të kontratës kundrejt dispozitave të garancisë për pagesat paraprake; - Pagesën me këste prej 40% për transportin e mallrave së bashku me dokumentet korresponduese; - Pagesën me këste prej 30% pas instalimit ose vënies në shfrytëzim për paraqitjen e dokumenteve korresponduese; - Pagesën përfundimtare prej 10% për skadimin e periudhës së garancisë ose për vënien në shfrytëzim	- Për shërbimet e ndërtimit, pagesa duhet të parashikohet në përputhje me progresin e ndërtimit. Kushtet duhet të përshtaten me projektin individual dhe me praktikën ndërkombëtare. **Vonesat** - Në rastin e vonesave të projektit (p.sh. punimet e ndërtimit në kantierin e ndërtimit), pagesat do të kryhen vetëm kur të sigurohet përfundimi i duhur i projektit. Dispozitat korresponduese për ndërprerjen e projektit duhet të përfshihen në kontratë. Nëse është e nevojshme, duhet të lidhen marrëveshje shtesë për ruajtjen e pjesëve të prodhuara ose zgjerimin e periudhave të shpërndarjes, grumbullimit ose garancisë. **Pagesat** - Pagesat kryhen direkt nga SECO-ja te kontraktuesi në përgjithësi mbi bazën e faturave të miratuara nga porositësi dhe konsulenti shoqërues.	përgatitura nga FIDIC-ja, si dhe "Marrëveshja Model e Shërbimeve të Klientit/Konsulentit" të përdorura shpesh. **Qartësia** - Kontrata përfundimtare duhet të rregullojë tërësisht dhe përfundimisht marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet palëve dhe nuk duhet të ndikohet nga fakti që rregullore të tjera, për shembull, kushtet e përgjithshme të kontratës, kontratat model, është rënë, gjithashtu, dakord të jenë të zbatueshme. Nëse një gjë e tillë është e pashmangshme, duhet të përcaktohet renditja e zbatimit të marrëveshjeve individuale. **Zbatimi** - Pjesët në vijim lidhen me paraqitjen e hollësishme të dispozitave më të rëndësishme që duhet të zbatohen në kontratat e shpërndarjes, shërbimit dhe të ndërtimit, sipas financimit të infrastrukturës nga SECO-ja. Në rastin e kredive të kombinuara, pagesat i bëhen kontraktuesit me anë të bankave bashkë-financuese mbi bazën e një shkrese kredie. Produktet e financuara në kuadrin e financimit të infrastrukturës në përgjithësi përjashtohen nga detyrimet dhe taksat doganore. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë këto taksa dhe detyrime nuk financohen nga fondet e grantit ose kreditë e kombinuara. Për këtë arsye, ato duhet të llogariten veçmas në çmimet dhe faturat përkatëse. **Kontratat e konsulencës** - Për shërbimet e konsulencës, duhet të përcaktohet tavani i kostos,

4. Garancia

Forma
- Forma e garancisë së kontraktuesit varet nga natyra e kontratës themelore.

Furnizimet e pajisjeve
- Për sa u përket furnizimeve të pajisjeve, kur është e mundur dhe e nevojshme, bihet dakord për një garanci në lidhje me materialet, cilësinë e pajisjeve, agregatet dhe pjesë të tjera thelbësore të pajisjeve, si dhe performancën e cila mbulon sasinë dhe cilësinë e performancës dhe konsumimin e lëndëve të para, mbështetëse dhe funksionale.

Punime ndërtimi
- Në rastin e punimeve të ndërtimit, garancia konsiston në detyrimin për të ruajtur ndërtesën gjatë periudhës së garancisë dhe për të riparuar çdo defekt që mund të dalë me qëllim që në fund të kësaj periudhe, ndërtesa mund t'i dorëzohet porositësit sipas specifikimeve të përcaktuara në kontratë. Kushtet e garancisë në lidhje me punimet e ndërtimit janë në përputhje me standardet e FIDIC-së.

7. Sigurimet
Parimet bazë

kundrejt dispozitës së garancisë së performancës.

Periudha e garancisë
- Periudha e garancisë është në përgjithësi ndërmjet një apo dy viteve pas pranimit.

Herë pas here është përcaktuar afati "i fundit" për plotësimin e kushteve të garancisë në rastin e vonesave në instalimet përkatëse për të cilat kontraktuesi nuk mban përgjegjësi pas dorëzimit të përpiktë.

5. Garancitë bankare

Parimet bazë
- Kushtet e kontratës duhet të parashikojnë për kontraktuesin sigurimin e garancisë së pagesës paraprake dhe nëse është e nevojshme, garancinë e performancës. Garancitë e mësipërme synojnë premtimin abstrakt të pagesës nga banka të njohura ose kompani sigurimesh, e pagueshme me kërkesën e parë, pa krijuar mundësinë për të kërkuar të drejta reciproke.

Garancia e pagesës paraprake
- Garancia e pagesës paraprake i shërben porositësit si një garanci që pagesa paraprake që ai ka kryer do t'i rikthehet në rast se kontraktuesi nuk plotëson detyrimet kontraktuale të nevojshme. Niveli i garancisë së pagesës paraprake përcaktohet nga niveli i pagesës paraprake. Vlera e garancisë mund të ulet në përputhje me vlerën e furnizimeve dhe shërbimeve që janë kryer gjatë zbatimit të kontratës.

Furnizimi i pajisjeve dhe dhënia e kontratave të ndërtimit
- Në fushën e pajisjeve dhe ndërtimit, format e zakonshme të sigurimeve mbulojnë risqet që lindin nga operimi në kantierin e ndërtimit dhe ndërtimi i godinës. Kjo, mbi të gjitha

Garancia e performancës
- Garancia e performancës i ofron porositësit sigurinë për plotësimin e duhur të të gjitha detyrimeve të kontratës, përfshirë kërkesat për garancinë nga kontraktuesi. Si rregull, kjo garanci arrin në 10% të vlerës së kontratës dhe përfundon me skadimin e periudhës së garancisë.

Nga ana tjetër, palët përkatëse mund të bien dakord për ruajtjen e një pagese me vlerë ekuivalente.

Pagueshmëria
- Garancitë duhet të bëhen pranë SECO-s dhe do të mbahen nga SECO-ja.

6. Dëmet dhe gjobat e zakonshme

Gjobat e zakonshme
- Në rast se kontraktuesi, për arsye për të cilat është përgjegjës, tejkalon afatin e lejuar për përfundimin e kontratës, parashikohet gjoba e zakonshme. Niveli i gjobës së zakonshme është rrjedhues.

8. Forca madhore

Parimet bazë
- Dispozitat e kontratës duhet të përmbajnë klauzola që udhëheqin rastet e forcës

i cili nëse është e nevojshme duhet të ndahet në faza. Shpërblimi bëhet në përputhje me shpenzimet aktuale të kryera. Faturimi bëhet në intervale për të cilat është rënë dakord (zakonisht tremujore ose mbi bazën e intervaleve korresponduese raportuese). Pagesat kryhen direkt nga SECO-ja për konsulentin mbi bazën e faturave të miratuara nga porositësi.

Marrëveshja ndërmjet masës dhe njësisë së kohës (p.sh., 02% të vlerës së kontratës në javë), përmes së cilës zakonisht arrihet marrëveshja për kufirin maksimal (p.sh., 15% të vlerës së kontratës).

- Gjithashtu, gjobat e zakonshme duhet të caktohen për mosarritjen e treguesve të performancës të rënë dakord me kontratë. Niveli i gjobës llogaritet mbi bazën e performancës së ulur, p.sh., që në rastin e mosarritjes së parametrave të rënë dakord me kontratë dhe me gjithë përpjekjet në përmirësimin e mëvonshëm, ndodh një ulje e çmimit në përputhje me shkallën e reduktimit të parashikuar në kontratë.

Dëmet
- Kontrata duhet të parashikojë detyrimin e kontraktuesit për të paguar dëmet për humbjet kur ai

- Është e nevojshme që të sigurohen furnizimet dhe punimet e ndërtimit në mënyrën e duhur dhe në masën e zakonshme ndaj të gjitha risqeve të mundshme deri në përfundimin dhe vënien në shfrytëzim të projektit, me qëllim që të mund të zëvendësohen apo riparohen në rastin e dëmtimit. **Sigurimi i transportit** - Sigurimi i transportit duhet të kryhet gjatë të gjithë periudhës së transportit, krijimin e klauzolave të ngarkesës (A) dhe nëse është e nevojshme krijimin e klauzolave (të ngarkesës) për periudhën e luftës dhe krijimin e klauzolave të (ngarkesës) për raste Greve të Institutit të financuesve të policës së sigurimit (botim i vitit 1982) në Londër ose është e nevojshme të arrihet marrëveshja për klauzola të ngjashme. Pagesat e kryera nga siguruesi në lidhje me pretendimet e porositësit duhet t'i paguhen SECO-s.	lidhet me sigurimet e pajisjeve dhe projektit të plotë (sigurimet e të gjitha risqeve të kontraktuesve) dhe sigurimet kundër dëmtimit personal. Pagesat e kryera nga siguruesi në lidhje me pretendimet e porositësit duhet t'i paguhen SECO-s.	madhore. Këto janë raste të pazakonta që pengojnë plotësimin e kushteve të kontratës dhe për të cilat asnjëra nga palët kontraktuese nuk është përgjegjëse, të tilla si: fatkeqësi natyrore, lufta, trazirat civile dhe grevat. **Provat** - Paraqitja e konfirmimit nga dhoma lokale e tregtisë apo një institucion i ngjashëm shërben normalisht si provë e ndodhjes së një rasti të forcës madhore që ka shkaktuar mos-përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. **Pasoja** - Pasojë e rastit të forcës madhore është shtyrja e afatit të furnizimit dhe shërbimit dhe për pasojë e periudhës së garancisë, për shkak të pezullimit të detyrimeve kontraktuale. Kontraktuesi është i detyruar të marrë pjesë në eliminimin e pengesës së performancës kontraktuale dhe të zbatojë masat për riparimin e dëmeve apo masa të tjera të jashtëzakonshme (p.sh. ruajtjen). Llogaritja e dëmtimeve bazohet në udhëzuesit e ERG-së.	është përgjegjës. Kontraktuesi duhet të jetë i pajisur me kontributet e sigurimeve për një rast të tillë. **9. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve** **Juridiksioni** - Vendi i juridiksionit për kontratat është Zvicra (Berne). **Arbitrazhi** - Pas dështimit përfundimtar të përpjekjeve për të arritur zgjidhje miqësore, zakonisht është rënë dakord që palët të parashtrojnë çështjen pranë gjykatës ndërkombëtare të arbitrazhit, p.sh., në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Arbitrazhit ose të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare (UNCITRAL). **Referencat** 1. Shihni SR 172.056.12 për pragun (urdhëresë e Prokurimeve Publike për pragun). 2. **SECO-ja** mban një bankë të dhënash të përhershme të konsulentëve që mund të përdoret në fazën para zgjedhore të kështilltarëve. 3. Shihni nenin 2 të

			urdhëresës për Garancinë ndaj Riskut në Eksport SR 946 111. 4. Kjo vlerë llogaritet mbi bazën e udhëzuesve të ERG-së dhe jo mbi bazën e dispozitave të legjislacionit doganor të origjinës (kriteri *ad-valorem*). 5. Shihni SR 946 111 (urdhëresë e DEA-s për kapacitetin minimal të vlerës së shtuar zvicerane për Garancinë ndaj Riskut në Eksport). 6. Pra, në përgjithësi paraqiten më pak se tre tenderues të mundshëm. 7. Federata Ndërkombëtare FIDIC e Inxhinierëve Konsulentë.

Impressum
Teksti: SECO-ja
Faqosja: CasalinI Werbeagentur AG
Ilustrimet: SECO-ja
Kontakti
Adresa:
Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike
SECO
Ndarja e Financimeve për Infrastrukturën e Zhvillimit dhe Tranzicionit
Effingerstrasse 1
3003 Berne/Zvicër
E-mail: indo-inet@seco.admin.ch
Telefon: +41 (0)31 324 09 18
Faks: +41 (0)31 324 09 65
Faqja e internetit: www.seco.admin.ch
Shtator 2003